

# Tabelat

## RREGULLIMET NË TË ARDHURAT

**Tabela A - Të Ardhurat me Burim te Huaj (në euro)**

	Shuma totale	Totali i përfshirë në PF	Rregullimi
	1	2	3
Të ardhurat neto nga Njësitë e Përhershme jashtë Kosovës Kutia (1)			
Të ardhurat nga dividendet Kutia (2)			
Të ardhurat nga kamata Kutia (3)			
Të ardhurat neto nga burime të tjera Kutia (4)			
<b>Totali: kutia (5) vendosni këtë shumë në kutinë [11] të deklaratës tatimore</b>			

**Tabela B – Arkëtimi i Borxheve të Këqija**

Emri i borxhliut	NRB të borxhliut (nëse ka)	Shuma e borxhit të fshirë	Data e fshirjes	Data e arkëtimit	Shuma e arkëtuar në 2006	Balanci i borxhit të keq të fshirë (Referohuni Doracakut)
1	2	3	4	5	6	7
<b>Totali</b>						
<b>Shuma e shënuar në Pasqyrën Financiare</b>						
<b>Rregullimi. Vendosni këtë shumë në kutinë [12] të deklaratës)</b>						

**Tabela C – Rregullimet në Fitimet (Humbjet) Kapitale**

Prona e patundshme	Asetet e zhvleresueshme të kategorisë 1	Aksionet	Obligacionet etj.	Shndërrimi i pavullnetshëm	Rregullimi total në fitimin (humbjen) kapitale
Zona a	Zona b	Zona c	Zona d	Zona e	Total
Totali i kolonës11	Totali i kolonës11	Totali i kolonës10	Totali i kolonës9	Totali i kolonës 9	kol. 1+2+3+4+5
1	2	3	4	5	6

Nëse kolona 6 është fitim kapital, vendoseni në kutinë [13] të deklaratës. Nëse kolona 6 është humbje kapitale, vendoseni në kutinë [25] të deklaratës.

## Zona (a)- Pasuria e patundshme, përveç aseteve të zhvlerësueshme të Kategorisë 1

Adresa	Data e shitjes	Çmimi i shitjes	Data e blerjes	Çmimi i blerjes/ Çmimi i ndërtimit	Kostoja e përmirësimit	Shpenzi met nga shitja	Zhvlerësimi i akumuluar	Fitimi/humbja 3-(5+6+7-8)	Raportuar në PF	Rregullimi në PF (kol. 9-10)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
<b>Totali: Vendoseni në kolonën 1 të tabelës C</b>										→

## Zona (b) - Asetet e zhvlerësueshme Kategoria 1

Përshkrimi	Data e shitjes	Çmimi i shitjes	Data e blerjes	Çmimi i blerjes/ Çmimi i ndërtimit	Kostoja e përmirësimit	Shpenzi met nga shitja	zhvlerësimi i akumuluar	Fitimi/humbja 3-(5+6+7-8)	Raportuar në PF	Rregullimi në PF (kol. 9-10)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
<b>Totali: Vendoseni në kolonën 2 të tabelës C</b>										→

## Zona (c)-Aksionet

Përshkrimi	Numri i aksioneve	Çmimi i shitjes për aksion	Çmimi i blerjes për aksion	Fitimi/humbja për aksion kol. 3-4	Fitimi/humbja para shpenzimeve	Shpenzimet (tarifat për ndërmjetësim për blerje/shitje)	Fitimi/humbja (pas shpenz.)	Raportuar ne PF	Rregullimi në PF kol. 8-9	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
<b>Totali: Vendoseni në kolonën 3 të tabelës C</b>										→

## Zona (d)- Obligacionet, obligacione të pagarantuara dhe tituj të tjerë të ngjashëm

Vlerë e emërtuar	Afati i maturimit	Emri i lëshuesit	Te ardhurat nga shitja	Kostoja	Shpenzimet e shitjes	Përfitimi/humbja 4-(5+6)	Raportuar ne PF	Rregullimi në PF	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	
<b>Totali: Vendoseni në kolonën 4 të tabelës C</b>									→

## Zona (e)- Shndërrimi i pavullnetshëm

Pershkrimi	Data e dëmtimit ose shkatërrimit	Data e zëvendësimit	Çmimi i blerjes/ Çmimi i ndërtimit	Totali i kostos së përmirësimit	Kompensimi	Përfitimi. Nëse zëvendësohet brenda 2 vjetëve vëje 0.  kol. 6-(4+5)	Raportuar ne PF	Rregullimi në PF  kol. 7-8
1	2	3	4	5	6	7	8	9
<b>Totali: Vendoseni në kolonën 5 të tabelës C</b> →								

## Tabela D – Dividentet e marrura nga Kompanitë Rezidente

Emri i kompanisë rezidente	NRB i kompanisë rezidente	Numri i aksioneve	Dividenti për aksion	Totali i dividendeve të marrur kol. 3x4
1	2	3	4	5
<b>Totali i lejuar</b> →				(0)
<b>Shuma e shënuar në Pasqyrën Financiare</b> →				
<b>Rregullimi. Vendose në kutinë [14] të Deklaratës</b> →				

## Tabela E – Të ardhura/fitime te tjera

Përshkrimi	Burimi i të ardhurave/përfitimit	Shuma
1	2	3
<b>Totali</b> →		
<b>Minus: Shuma e treguar në PF</b> →		
<b>Rregullimi. Vendose në kutinë [15] të Deklaratës</b> →		

## RREGULLIMET NË SHPENZIME

### Tabela F – Shpenzimet e pazbritshme

Kostoja e blerjes dhe përmirësimit te tokës	Gjobat dhe ndëshkimet	Kostoja e blerjes/ndërtimit të aseteve të amortizueshme apo të zhvlerësueshme	TVSH e zbriteshme për të cilën është bërë kërkesa për rikthim apo rimbursim	Tatimi në fitim/i paragjykuar	Tatimi në të ardhura personale	Totali (1 deri 6)
1	2	3	4	5	6	7
<b>Totali i lejuar</b>						[0]
<b>Minus: E përfshirë në PF</b>						
<b>Rregullimi. Vendose në kutinë [18] të Deklaratës</b>						

### Tabela G – Shpenzimet e përfaqësimit

Qarkullimi për periudhën tatimore	Kufiri i lejuar Kol. 1x2%
1	2
	[a]
<b>Minus shuma në PF</b>	[b]
<b>Rregullimi</b>	[c]

Nëse shuma e përfshirë në PF është më e lartë sesa limiti i lejuar, kutiza [a], vendose shumën në kutizën [c] në kutinë [19] të deklaratës. Nëse shuma e përfshirë në PF është më e ultë se kutiza [a], vendose 0 në kutinë [19] të deklaratës.

### Tabela H(a) – Fondet Rezervë për asetet e dyshimta (vetëm për bankat)

Shuma e krijimit	Lejuar nga BPK	Tejkalimi Kol. 2-1	Shuma e tërhequr	Shuma e rivendosur	E lejuar si shpenzim kol. 1+5-(3+4)
1	2	3	4	5	6

### Tabela H(b)- Fondet rezervë – Biznesi dhe Bankat

Natyra	Shuma e regjistruar në PF
1	2

**Bizneset: Vendose totalin e kolonë 2 në kutinë 20 të deklaratës**

**Bankat: zbritë totalin e kolonës 2 nga shuma e kol. 6 të Tabelës H(a). Vendose ndryshimin në kutinë 20 të deklaratës.**

## Tabela I – Pagesat për Personat e Lidhur

	Shumat për PF	Çmimi i tregut/Vlera e hapur e tregut	Rregullimi kol.2-1
	1	2	3
Kompenzimet dhe shpërblimet			
Kamata			
Qiraja			
Pagesat tjera			
<b>Totali. Vendose totalin e kolonës 3 në kutinë [21] të deklaratës</b>			→

## Tabela J – Zhvlerësimi Total i Lejueshëm

1	2	3
	Burimi	Shuma
Kategoria 1	Tabela J(a) kolona 6	
Kategoria 2	Tabela J(b) kolona 7	
Kategoria 3	Tabela J(c) kolona 7	
<b>Totali i zbritshëm</b>		→
<b>Minus: Regjistruar në PF</b>		→
<b>Rregullimi. Vendose në kutinë [22] të deklaratës</b>		→

## Tabela J (a) – Zhvlerësimi -Kategoria 1 Ndërtesat dhe strukturat ndërtimore

Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit 2006 Zona 1	Kostoja e blerjes Zona 2	Kostoja e ndërtimit Zona 3	Riparimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi / Zona 4	Vlera totale Baza për llogaritjen e zhvlerësimit kol. 1+2+3+4	Shpenzimet e zhvlerësimit kolona 5x5%	Vlera e mbetur (e pa zhvlerësuar) në fund të vitit kol.5-6
1	2	3	4	5	6	7

Vendose shumën e kolonës 6 të kësaj table në kutinë 1, kolona 3 të tabelës J.

## Zona 1-Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit

Përshkrimi i asetit	Viti i blerjes	Numri i viteve që nga blerja (2006-kol.2)	Vlera në kohën e blerjes	Zhvlerësimi i akumuluar (kol. 4x5%) x kol.3	Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit Kol.4-kol.5
1	2	3	4	5	6
<b>Totali: Vendose shumën në kolonën 1 të tabelës J(a)</b>					→

## Zona 2 - Kostoja e blerjes

Përshkrimi i asetit	Çmimi i blerjes	Transporti	Sigurimi	Shpenzimet totale të blerjes 2+3+4	Data e vënies në shërbim	Shuma e lejuar nëse është vënë në shërbim në 2006
1	2	3	4	5	6	7
<b>Totali: Vendose shumën në kolonën 2 të tabelës J(a)</b> →						

## Zona 3 - Kostoja e ndërtimit te aseteve

Përshkrimi	Kostoja e materialit	Tatimet e aplikueshme	Taksat e aplikueshme	Kamata	Totali (2+3+4+5)	Data e vënies në shërbim	Shuma e lejuar nëse është vënë në shërbim në 2006
1	2	3	4	5	6	7	8
<b>Totali: Vendose shumën në kolonën 3 të tabelës J(a)</b> →							

## Zona 4 – Shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit

Totali i riparimit për vitin	Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit	5% e kolonës 2	(1-3)
1	2	3	4

Nëse shuma totale në kolonën e 1 zona 4 tejkalon shumën në kolonën 3, ndryshimin (shumën e kolonës 4) të kësaj table vendose në kolonën 4 të tabelës J(a); nëse jo vendose 0 në kolonën 4 të tabelës J (a)

### Tabela J(b)- Zhvlerësimi i aseteve te kategorisë 2

Veturat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, buldozerët, gërmuesit e dheut ,kompjuterët ,mobiliet,pajisjet e zyrës etj.

Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të këtij viti	Kostoja e blerjes	Kostoja e ndërtimit	Riparimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi	Shuma e shitjes	Vlera totale Baza për llogaritjen e zhvlerësimit	Shpenzimet e zhvlerësimit 20% i kolonës 6	Vlera e pa zhvlerësuar në fund të vitit
Zona 5	Zona 6	Zona 7	Zona 8	Zona 9	kol. 1+2+3+4-5	6	kol.6-7
1	2	3	4	5	6	7	8

**Vendose shumën e kolonës së 7 të kësaj table në kutinë 2, kolona 3 tabelës J.**

## Zona 5-Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit.

Përshkrimi i asetit	Viti i blerjes	Numri i viteve që nga blerja (2006- kol.2)	Vlera në kohën e blerjes	Zhvlerësimi i akumuluar Kol .4 x 20 % x kol..3	Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit Kol. 4-kol.5
1	2	3	4	5	6
<b>Totali: Vendose vlerën në kolonën 1 të tabelës J(b)</b>					→

## Zona 6 – Kosto e blerjes

Përshkrimi	Çmimi i blerjes	Transporti	Sigurimi	Kostoja totale e blerjes Kol. 2+3+4	Çmimi i blerjes ≥ 1000 Nëse po, vendose shumën e regjistruar në kolonën e 5. Nëse jo vendose 0.	Data e vënies në shërbim	Nëse asetet janë vënë në shërbim gjatë vitit tatimor vendose shumën e regjistruar në kolonën e 6. Nëse jo vendose 0.
1	2	3	4	5	6	7	8
<b>Totali: Vendose këtë vlerë në kolonën 2 të tabelës J(b)</b>					→		

## Zona 7- Kostoja e ndërtimit të aseteve

Përshkrimi	Kosto e materialeve	Tatimet e aplikueshme	Detyrimet doganore të aplikueshme	Kamata	Totali i shpenzimeve të ndërtimit Kol. 2+3+4+5	Kosto e ndërtimit ≥ 1000 Nëse po, vendose shumën e regjistruar në kolonën 6. Nëse jo vendose 0	Data e vënies në shërbim	Nëse asetet janë vënë në shërbim gjatë vitit tatimor vendose shumën e regjistruar në kolonën e 6. Nëse jo vendose 0.
1	2	3	4	5	6	7	8	9
<b>Totali: Vendose këtë vlerë në kolonën 3 të tabelës J(b)</b>					→			

## Zona 8 – Shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit

Totali i riparimit për vitin	Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit sipas kolonës 1 të tabelës J(b)	5% e kolonës 2	(1-3)
1	2	3	4

Nëse shuma totale në kolonën e 1 zona 8 tejkalon shumën në kolonën 3, ndryshimin (shumën e kolonës 4) të kësaj table vendose në kolonën 4 të tabelës J(b); nëse jo vendose 0 në kolonën 4 të tabelës J(a)

## Zona 9 – Shuma e shitjes

Përshkrimi	Data e shitjes	Te ardhurat nga shitja
1	2	3

**Totali: Vendose këtë vlerë në kolonën 5 të tabelës J(b)** →

## Tabela J(c) – Zhvlerësimi i aseteve te kategorisë 3

### Uzinat, lokomotivat dhe inventari i hekurudhës, aeroplanët, anijet etj.

Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit 2006	Kostoja e blerjes	Kostoja e ndërtimit	Riparimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi	Shuma e shitjes	Vlera totale Baza për llogaritjen e zhvlerësimit	Shpenzimet e zhvlerësimit 15% i kolonës 6	Vlera e pa zhvlerësuar në fund të vitit
Zona 10	Zona 11	Zona 12	Zona 13	Zona 14	kol.1+2+3+4-5	7	kol.6-7
1	2	3	4	5	6	7	8

Vendose vlerën e kolonës 7 të kësaj table në kutinë 3, kolona 3 të tabelës J.

## Zona 10-Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit.

Përshkrimi i asetit	Viti i blerjes	Numri i viteve që nga blerja (2006-kol.2)	Vlera në kohën e blerjes	Zhvlerësimi i akumuluar Kol .4 x 15 % x kol..3	Vlera e pazhvlerësuar në fillim të vitit Kol. 4-kol.5
1	2	3	4	5	6

**Totali: Vendose këtë shumë në kolonën 1 të tabelës J(c)** →



## Zona 11 –Kostoja e blerjes

Përshkrimi	Çmimi i blerjes	Transporti	Sigurimi	Kostoja totale e blerjes  2+3+4	Kosto e blerjes ≥ 1000 Nëse po, vendose shumën e regjistruar në kolonën e 5. Nëse jo vendose 0.	Data e vënies në shërbim	Nëse asetë është vënë në shërbim gjatë vitit tatimor Vendose shumën e regjistruar në kolonën e 6. Nëse jo vendose 0.	
1	2	3	4	5	6	7	8	
<b>Totali: Vendose këtë vlerë në kolonën 2 të tabelës J(c)</b>							→	

## Zona 12- Kostoja e ndërtimit të aseteve

Përshkrimi	Kosto e materialeve	Tatimet e aplikueshme	Detyrimet doganore të aplikueshme	Kamata	Totali i shpenzimeve të ndërtimit  Kol. 2+3+4+5	Kosto e ndërtimit ≥ 1000 Nëse po, vendose shumën e regjistruar në kolonën 6. Nëse jo vendose 0	Data e vënies në shërbim	Nëse asetët janë vënë në shërbim gjatë vitit tatimor vendose shumën e regjistruar në kolonën e 6. Nëse jo vendose 0.
1	2	3	4	5	6	7	8	9
<b>Totali: Vendose këtë vlerë në kolonën 3 të tabelës J(c)</b>							→	

## Zona 13 – Shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit

Totali i riparimit për vitin	Vlera e pa zhvlerësuar në fillim të vitit sipas kolonës 1 të tabelës J(c)	5% e pikës 2	(1-3)
1	2	3	4

Nëse shuma totale në kolonën 1 zona 13 të tejkalon shumën në kolonën 3, ndryshimin (shumën e kolonës 4) të kësaj table vendose në kolonën 4 të tabelës J(c); nëse jo vendose 0 në kolonën 4 të tabelës J (a)

## Zona 14 – Shuma e shitjes

Përshkrimi	Data e shitjes	Te ardhurat nga shitja
1	2	3
<b>Totali: Vendose këtë vlerë në kolonën 5 të tabelës J(c)</b>		→

## Tabela K – Amortizimi-Shpenzimet e asetëve të patrupëzuara dhe shpenzimet e eksplorimit dhe zhvillimit

Shpenzimet e asetëve të patrupëzuara Zona 15 kolona 10	Shpenzimet e eksplorimit dhe zhvillimit Zona 16, kolona 7	Totali kol.1+2
1	2	3
<b>Minus: Shuma e paraqitur në Pasqyrën Financiare Rregullimi. Vendose në kutinë [23] të deklaratës</b>		→

## Zona 15- Shpenzimet e asetëve të patrupëzuara (patentat, të drejtat e autorit, markat tregtare etj)

Përshkrimi i asetit	Data e marrëveshjes legale	Numri i viteve që nga marrëveshja legale 2006-kol.2	Numri i viteve të marrëveshjes legale Kohëzgjatja e marrëveshjes	Shpenzimet totale para 2006	Amortizimi para 2006 (referohu doracakut)	Të paamortizuara në fillim të 2006	Shpenzimet në 2006	Totali për t'u amortizuar	Amortizimi në vitin 2006 (referohu doracakut)	Balanci i mbylljes për 2006 (referohu në doracak)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
<b>Totali: Vendose totalin e kolonës 10 në kolonën 1 të tabelës K</b>									→	

## Zona 16 –Shpenzimet e eksplorimit dhe zhvillimit

Përshkrimi	Bilanci i hapjes (referohu doracakut)	Shpenzimet e eksplorimit dhe zhvillimit gjatë vitit	Kamata e aplikueshm e gjatë vitit	Vlera për t'u amortizuar kol.(2+3+4)	Njësitë e nxjerrura të pjesëtuara me numrin total të njesive të vlerësuara	Amortizimi i lejuar kol.5xkol. 6	Bilanci i mbyllur Kol. 5-7
1	2	3	4	5	6	7	8

**Totali: Vendose totalin e kolonës 7 në kolonën 2 të tabelës K** →

## Tabela L – Lejimi special për asetet e reja të kategorisë- 3

Kosto e blerjes Kolona 2 të tabelës J(c)	Kosto e ndërtimit Kolona 3 të tabelës J(c)	Kosto totale e blerjes dhe ndërtimit Kolonat 1+2	Shpenzimet e lejesës speciale Kolona 3 x 5%
1	2	3	4

**Vendose shumën totale të kolonës 4 në kutinë 24 të deklaratës**

## Tabela M- Shpenzimet/humbjet e tjera

Natyra e shpenzimit	E lejueshme	Raportuar në P.F	Regullimi 4=(2-3)
1	2	3	4
Përmirësimi i objekteve ne qiradhënje Kutia (1)			
Kontributet bëmirëse Kutia (2)	0		(      )
Riparimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi Kutia (3)			(      )
Transporti, Sigurimi Kutia (4)			
Shpenzimet e blerjes/ndërtimit nën 1,000 euro Kutia (5)			

**Vendose shumën totale të kolonës 4 në kutinë 26 të deklaratës** →

## Tabela N – Kontributet e lejueshme bëmirëse

Data e kontributit	Pranuesi i kontributit	Shuma e kontributit
1	2	3
<b>Totali:</b>		[a]
<b>Kontributet e lejueshme: Kutia 28 e deklaratës x 5 %</b>		[b]

Nëse shuma në (a) është më e lartë se (b), vendose shumën në (b) në kutinë 29 të deklaratës; Nëse shuma në (a) është më e ultë se (b), vendose shumën në(a) në kutinë 29 të deklaratës.

## Tabela O –Kreditimi tatimor i shtetit të huaj

Njësia e Përhershme jashtë Kosovës (Zona 17)	Tatimi i mbajtur në burim mbi të ardhura te tjera nga shtetet e huaja (Zona 18)	Totali i kreditit tatimor të shtetit të huaj
1	2	3

Vendose vlerën e kolonës 3 në kutinë 34 të deklaratës.

## Zona 17 – Tatimi në fitim i paguar nga Njësitet e Përhershme jashtë Kosovës

Shteti i huaj	Fitimi i tatueshëm në valutë të huaj	Tatimi në fitim i paguar në valutë të huaj	Koeficienti i konvertimit	Fitimi i tatueshëm në euro <small>kol. 2x4</small>	Tatimi në fitim i paguar në shtetin e huaj në euro <small>(kol. 3x4)</small>	Shuma që do të paguhej në Kosovë <small>(kol. 5x20%)</small>	Kredia e lejueshme  <small>(referohu doracakut)</small>
1	2	3	4	5	6	7	8

Vendose totalin e kolonës 8 në kolonën 1 të tabelës O

## Zona 18 – Tatimi i mbajtur në burim nga shteti i huaj në të ardhura tjera

Data	Natyra	Shuma e tatueshme në valutë të huaj	Tatimi i mbajtur në burim në valutë të huaj	Koeficienti i këmbimit	Shuma e tatueshme e konvertuar <small>(kol. 3x5)</small>	Tatimi i mbajtur në burim i konvertuar <small>(kol.4 x 5)</small>	Tatimi i Kosovës <small>(kol. 6x20%)</small>	Kredia e lejueshme  <small>(referohu doracakut)</small>
1	2	3	4	5	6	7	8	9

Vendose totalin e kolonës 9 në kolonën 2 të tabelës O

**TABELA P – Tatimi i mbajtur në burim nga paguesit Rezidente në të ardhurat nga:dividenta,kamata ,perqindjet e fitimit (nga e drejta e autorit,e patentes,apo e shfrytezimit te burimeve natyrore), qirate**

Te ardhurat nga dividenta	Tatimi i mbajtur në burim ne dividenta	Te ardhurat nga kamata	Tatimi i mbajtur në burim në kamate	Te ardhurat nga perqindjet e fitimit (te drejta e autorit, e patentes,etj.)	Tatimi i mbajtur në burim ne perqindjet e fitimit	Te ardhurat nga qirate	Tatimi i mbajtur në burim ne qira	Kredia e lejueshme  (referohu doracakut) (2+4+6+8)
1	2	3	4	5	6	7	8	9
<b>Vendose totalin e kolonës 9 në kutinë 38 të deklaratës.</b> →								

**Tabela Q – Këstet e paguara**

Tremujori	Shuma
1 Janar – 31 Mars	
1 Prill – 30 Qershor	
1 Korrik – 30 Shtator	
1 Tetor – 31 Dhjetor	
<b>Vendose shumën totale në kutinë [41] të deklaratës</b> →	



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCËVE – MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE  
**ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO**

---

# **DORACAKU I TATIMIT NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE**

---

[WWW.ATK-KS.ORG](http://WWW.ATK-KS.ORG)  
[INFO@ATK-KS.ORG](mailto:INFO@ATK-KS.ORG)

## INFORMATA TË PËRGJITHSHME

### Përpara se të filloni:

#### *Përpara se të plotësoni deklaratën tuaj tatimore*

Përpara se të plotësoni deklaratën tuaj tatimore, ju lutemi shfrytëzoni kohën të lexoni pjesën e informatave të përgjithshme të këtij doracaku dhe të gjitha pikat që ekzistojnë në deklaratën tuaj. Kjo do t'u parandaloj të bëni gabime.

#### *Po nëse keni nevojë për ndihmë?*

Në këtë doracak, kemi përdorur një gjuhë të thjeshtë për të sqaruar rastet tatimore më të zakonshme. Nëse keni nevojë për më tepër ndihmë pasi ta keni lexuar këtë doracak, mund të na kontaktoni nëpërmjet numrave vijues:

Prishtinë	038/200 255 17 , 200 255 38
Prizren	029/42 989; 029/44-901
Gjilan	0280/26 967; 0280/20-097
Pejë	039/21 119; 039/32-124
Mitrovicë	028/30 058;
Gjakovë	0390/30 021; 0390/30-019
Ferizaj	0290/26 238 ; 0290/27-306

Poashtu mund t'i vizitoni edhe zyrat regjionale të Administratës Tatimore të Kosovës të cilat zyra janë të hapura nga e Hëna deri të Premten, prej orës 8:00 paradite deri në ora 4:30 mbasdite.

#### *Përpara se të na kontaktoni*

Ne dëshirojmë t'u sigurojmë juve shërbimet më të mira të mundshme. Duke qenë të përgatitur paraprakisht, ju do të na ndihmoni të ju shërbejmë sa më mirë. Përpara se të kontaktoni me ne ju duhet të kryeni **të gjitha** këto:

- Të lexoni pjesët e duhura të këtij doracaku, të rregulloreve 2004/51, 2005/51 dhe udhëzimeve administrative që lidhen me të;
- Të përgatisni të gjitha hollësitë e gjendjes suaj dhe pyetjet; dhe
- Të keni me vete fotokopjen e formularit të deklaratës, çfarëdo dokumenti që lidhet me të, një laps, ndonjë letër, dhe numrin e regjistrimit të biznesit tuaj (NRB).

***Marrja e informatave tatimore***

Informatat tuaja tatimore janë të besueshme. Sidoqoftë ju mund të autorizoni dikë (sikurse mbajtësin tuaj të librave apo kontabilistin) të ju përfaqësoj që të bisedohet lidhur me dosjen tuaj. Shih më poshtë “Përfaqësuesit”. Në raste të caktuara, ne disa prej informatave tuaja ua japim trupave qeveritar sikurse është Shërbimi Doganor i UNMIK-ut për të administruar ligjin. Në të gjitha rastet, ne iu përmbahemi procedurave të rrepta përpara se t’ia japim dikuj informatat tuaja.

Në qoftë se na vizitoni dhe kërkoni informata tatimore, ne do të kërkojmë që ju të identifikoni vetveten. Përveç kësaj ne do të kërkojmë edhe këto:

- Një letërnjoftim (ID) të nënshkruar dhe me fotografinë tuaj; apo
- Dy dokumente identifikimi të nënshkruara; dhe
- Dokumentet tuaja tatimore sikurse janë deklaratat tatimore tremujore të kësteve.

Asnjë informatë tatimore nuk do të jepet nëpërmjet telefonit.

***Përfaqësuesit***

Ju mund të autorizoni një përfaqësues (mbajtës librash, kontabilist) të marrë informata për çështjet tuaja. Megjithatë, ne do t’u japim informata përfaqësuesve tuaj vetëm pasi ne të jemi bindur se ju na keni autorizuar me shkrim ta bëjmë atë.

Në qoftë se përfaqësuesi juaj na viziton, dhe kërkon informata mbi tatimet në emër tuajin, ne do t’i japim këto informata vetëm nëse përfaqësuesi juaj na siguron dokumentin të nënshkruar nga ju. Pasi të konfirmojmë se ne kemi lejen tuaj me shkrim, ne do të kërkojmë nga përfaqësuesi juaj edhe:

- Një letërnjoftim (ID) të nënshkruar me fotografinë e tij apo saj; apo
- Dy dokumente identifikimi të nënshkruara.
- Informatat rreth përmbajtjes së deklaratave tuaja të kësteve tremujore të tatimit në fitim.

Nuk do t’i jipen informata tatimore përfaqësuesit tuaj nëpërmjet telefonit.

***Kush duhet të bëjë deklarin e tatimit në të Ardhurat e Korporatave?*****Per Periudhen Tatimore 2006 e tutje**

a) Nje Korporate apo ndonjë ndermarje tjetër afariste qe ka statusin e personit juridik sipas ligjit ne fuqi ne Kosovë; dhe ka te ardhurat vjetore bruto 50.001 apo me shume,llogarite te ardhurat e tatueshme duke pergaditur pasqyrat financiare dhe duke bere pershtatjen e te ardhurave e shpenzimeve te regjistruara ne pasqyrat e tilla, siq eshte parapare me Rregulloren Nr.2004/51 me Rregulloren Nr. 2005/51 permes tabelave percjellese te deklarates tatimore.

Bineset qe nuk e plotesojen kushtin e larte shenuar munde te rregjistrohen ne baze vullnetare per te deklaruar te ardhurat e tyre ne baze te fitimit real. Kete regjistrim mund ta bejne brenda periudhes tatimore dhe te njejtit marrin per obligim te krijojne pasqyra financiare bazur ne rregullat e standardeve te kontabilitetit. Korporatat te cilat vedosin te deklarojne tatimin e tyre ne baza vullnetare obligohen qe edhe ne vitet vijuese te



vazhdojnë me krijimin e pasqyrave financiare dhe delarimin e tatimit në baze të fitimit real.

- b) Një ndermarrje afariste që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike;
- c) Një organizatë e regjistruar në UNMIK si organizatë joqeveritare në baze të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/22 të datës 15 nëntore 1999 mbi regjistrimin dhe punën e organizatave joqeveritare në Kosovë dhe
- d) Një ndermarrje e përhershme e një personi **jo resident**.

**Pa marrë parasysh se kur mbrenda vitit është mbërritur pragu i qarkullimit vjetor,** bizneset është dashur të parashohin se ata do të mund të mbërrinë pragun (limitin) mbrenda vitit, prandaj gjithnjë duhet të kenë regjistrimet e duhura dhe duhet të jenë në gjendje të përgatisin pasqyrat financiare.

### **Kur duhet të dorëzoni deklaratën tuaj të tatimit në të ardhurat e korporatave?**

Ju duhet të dorëzoni deklaratën e tatimit në , të ardhurat e korporatave më së largu deri më 1 Prill te vitit vijues (te vitit tjetër në vazhdim) për vitin paraprak( për periudhën tatimore paraprake). Ata që deklarojnë më vonë do t'i nënshtrohen gjobave dhe kamatës.

### ***Çfarë gjoba dhe kamatë aplikojmë?***

Tatimpaguesit të cilët zgjedhin të paguajnë pagesa paradhënie bazuar në parashikimin e tyre dhe ato pagesa paradhënie rezultojnë të pamjaftueshme krahasuar me detyrimin tatimor final do të ndëshkohen vetëm për tremujorin e fundit të vitit të parë. Për vitin e dytë dhe vitet vijuese pasi që opioni për të paguar pa ndëshkime dhe interes është në dispozicion ata do të ndëshkohen për secilin këst tremujor nëse janë bërë pagesat e pamjaftueshme gjatë vitit.

Në rastet kur këstet e para janë shumë të vogla dhe këstet e fundit janë shumë të larta, ndëshkimet do të aplikohen për këstet e para derisa pagesat e tepërta të mëvonshme të kenë mbuluar deficitet. Në rastet kur këstet e para kanë qenë shumë të larta dhe këstet e fundit janë shumë të ulta, ATK do të njohë tepricat në periudhat e para që mbulojnë deficitet në periudhat e fundit dhe ndëshkimet mund ose mund të mos aplikohen varësisht nga shumatat e tepërta dhe deficiteve

Aty ku vetëm periudha e fundit e këstit tremujor do të ndëshkohet sipas 15.3 ? më sipër, atëherë Administrata Tatimore do të konsiderojë dhe ndëshkojë bazuar në shumatat e kësteve kumulative krahasuar me detyrimin vjetor, sesa thjesht të merret vetëm kësti i fundit si i izoluar.

Nenin 31.2.c.(ii) i Regullores 2004/51 i referohet pagesave të bazuara në detyrimin tatimor të vitit të kaluar. Aty ku tatimpaguesi ka humbje tatimore për një vit të veçantë, atëherë duke përdorë bazat e detyrimit tatimor të vitit të kaluar dhe aplikimi i llogaritjes 110% do të nënkuptonte se nuk nevojiten këste në vitin vijues dhe aty ku këstet është dashur të paguhet, nuk do të ketë ndëshkim për nënparashikim për shkak të përdorimit të këtij opioni.

Tatimpaguesit në vitin e tyre të parë kërkohet të përdorin bazat e parashikimit dhe parashikimet janë të bazuara në  $\frac{1}{4}$  e detyrimit tatimor vjetor të parashikuar për vitin e parë. Për ata të cilët fillojnë si tatimpagues gjatë tremujorit të parë kjo nuk është ndonjë problem, por për ata të cilët fillojnë më vonë në vit, ata kërkohet të paguajnë  $\frac{3}{4}$ ,  $\frac{1}{2}$  ose vetëm  $\frac{1}{4}$  të detyrimit në këste gjatë vitit të parë. Për vitin e dytë, duke paguar në bazë të viti të parë të pjesëshëm ?do të nënkuptojë se nuk do të paguhet ndëshkim për nënparashikim.

Në rastet kur ka pasur një kontrollë në vitin vijues që përcakton një detyrim tatimor vjetor tjetër për një vit të mëparshëm tatimor, nëse detyrimi vjetor tatimor është gjetur të jetë i lartë, ndëshkimet do të aplikoheshin për nëndeklarim, për pagesë me vonesë dhe poashtu interes për detyrimin vjetor të paguar më pak. Ndëshkimet e tilla dhe interesi për detyrimin tatimor shtesë të gjetur si rrjedhojë e kontrollit do të aplikohen vetëm në detyrimin tatimor vjetor, dhe nuk do të bëhet rregullim në shumat e kësteve të kaluara tremujore. ?

Formulari vjetor i tatimit në të ardhurat e korporatave është një deklaratë tatimore por pasqyrat e pagesës paradhënie nuk do të gjykohen si deklarata tatimore. Ndëshkimi për deklaram me vonesë nuk do të aplikohet mbi formularët e kësteve tremujore që dorëzohen me vonesë, por ndëshkimet dhe interesi për pagesë me vonesë do të aplikohen.

Në qoftë se dështoni të paguani tatimet kur ato të kenë afatin, do të ngarkoheni me **gjobë** prej 2% të balancës së tatimit borxh për secilin muaj apo pjesë të muajit për të cilën pagesa është vonë, deri në maksimum prej 12 muajsh. Poashtu i nënshtroheni kamatës në shumat e prapambetura prej 1.5% për secilin muaj apo pjesë të muajit nga data kur tatimi ka lindur deri më datën dhe përfshirë datën kur tatimi është paguar.

Përveç kësaj, nëse nuk dorëzoni deklaratën me kohë, ne do të ju ngarkojmë me gjobën prej 5% për deklarim të vonuar për tatimin borxh për secilin muaj apo pjesë të muajit për të cilën jeni vonë, jo më shumë se 25% të totalit të tatimit borxh.

### ***Si të dorëzoni deklaratën e Tatimit në te Ardhura te Korporatave ?***

Ju duhet të dorëzoni deklaratën, me pagesën tatimore nëse keni, në cilëndo prej bankave komerciale të Kosovës të autorizuara nga Administrata Tatimore të pranojë deklaratat e tilla.

Momentalisht të gjitha bankat komerciale të njohura zyrtarisht nga Autoriteti Bankar i Pagesave (BPK) kanë të drejtë të pranojnë deklaratat tatimore. Banka juaj do të trajtojë këtë deklaratë dhe do ta regjistrojë pagesën tuaj në tabelën e Informatorit të Pagesave Bankare ashtu siç është bërë me çdo deklaratë tjetër, madje edhe nëse ka diçka të bashkëngjitur. Nëse nuk ka pagesë, ju mund të dorëzoni deklaratën në zyrën e Administratës Tatimore të regjionit tuaj. Me rastin e dorëzimit të deklaratës perfundimtare ju jeni të obliguar të bashkëngjiti edhe pasqyrat financiare të parapara me standardet e kontabilitet si dhe qertifikatat e tatimit të mbajtur në burim nga të tjeret.

### ***Çka përfshini me deklaratën tuaj dhe çfarë regjistrimesh mbani?***

Duhet të përfshini deklaratën e tatimit në të ardhurat e korporatave, tabelat përkrahëse, pasqyrat financiare, certifikatat e tatimit të mbajtur në burim, si dhe dokumente tjera të aplikueshme. Dokumentet tjera që kërkohen të bashkëngjiten do të tregohen në doracak. Nëse dështoni të bashkëngjiti të gjitha dokumentet e kërkuara, do të pasojë kontrolli. Nëse keni të drejtë për rimbursim dhe dështoni të bashkëngjiti dokumentacionin e kërkuar, përpunimi i rimbursimit tuaj do të shtyhet.

Duhet t'i mbani në dispozicion të gjitha dokumentet përkrahëse sikurse janë faturat e shitjes dhe blerjes, dokumentet doganore, kontratat, dokumentet investuese, të gjitha dokumentet mbi përfshirjen jashtë vendit për biznes qoftë nëpërmjet njësisë së

përhershme apo jo etj., për t'u rishikuar nga zyrtarët e Administratës Tatimore. Poashtu duhet të mbani të gjitha informatat të shfrytëzuara për përgatitjen e tabelave përkrahëse të deklaratës tatimore dhe atë në një rregull (rend) të përkryer.

Poashtu duhet të mbani kopjen e deklaratës dhe të gjitha dokumenteve që dorëzoni në Administratën Tatimore.

## **Pasi të deklaroni**

### ***Ç'ndodh me deklaratën tuaj pasi ta pranohet?***

Kur të marrim deklaratën tuaj nga banka ku është dorëzuar, ne i futim ato informata në sistemin e Teknologjisë Informative (TI). Sistemi i TI i regjistron informatat mbi të gjitha tatimet të cilat ju i nënshtroheni si dhe informatat tjera sikurse janë importet.

Të gjitha deklaratat e tatimit në të Ardhurat e korporatave do të kontrollohen mbrenda një periudhe të caktuar me ligj. Periudha e caktuar me ligj aktualisht është gjashtë vjet nga data kur tatimi bëhet borxh për t'u paguar. Nuk ka nevojë që tatimpaguesit të bëjnë fjalë se ata nuk është dashur të caktohen me tatim shtesë nëpërmjet kontrollit vetëm pse konkurenti i tij ende nuk është kontrolluar. Gjithashtu nese keni leshuar ndonje gabim gjate deklarimit ju keni mundesi te beni korigjimet tuaja brenda pese viteve, pasojat e gabimeve deri ne momentin e korigjimit do ti mbartni ju.

### ***Kur mund të prisni rimbursimin tuaj?***

Kur të bëhet kërkesa për rimbursim, ajo duhet të vlerësohet brenda 60 diteve nga dita e aplikimit. Përparësi do t'u jepet atyre të cilët kanë bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Kur t'i nënshtrohet kontrollit një biznes, tatimpaguesi apo përfaqësuesi i tij dhe të gjithë të punësuarit kyç duhet të pranojnë të bëhet intervista fillestare nga zyrtarët e Administratës Tatimore. Inspektorët tatimor duhet të kenë qasje të plotë në të gjitha objektet përfshirë edhe depot. Tatimpaguesit duhet t'ia sigurojnë inspektorëve tatimor të gjitha librat dhe regjistrimet dhe duhet të pajtohen të fotokopjonë dokumentet e kërkuara nga inspektorët tatimor. Tatimpaguesit duhet të vënë në dispozicion stafin e tyre për të ju përgjigjur **të gjitha** pyetjeve të inspektorit tatimor. Të gjitha pikat e deklaratës mund t'i nënshtrohen shqyrtimit të hollësishëm. Moskooperimi me zyrtarët e Administratës Tatimore do të vonojë përpunimin e rimbursimit.

Rimbursimi i kërkuar padrejtesisht do të ndeshkohet bazuar në rregulloren Nr.2005/48 (Neni 45) mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat .

## DEKLARATA JUAJ E TATIMIT NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

Rregullorja 2004/51 “Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave” parasheh te ardhurat e perjashtuara (Neni 6 ); shpenzimet e lejueshme (Neni 7 ); shpenzimet e palejueshme (Neni 8) dhe shpenzimet pjeserishte te lejueshme (Neni 9-19) dhe rregullime të numërta për shpenzimet. Kjo nënkupton se nuk mund të përdorni ashtu thjesht informatat në pasqyrën tuaj financiare për të përcaktuar fitimin e tatueshëm. Ju duhet të rregulloni të dyja si pjesën e të ardhurave ashtu edhe pjesën e shpenzimeve të pasqyrës së të ardhurave për të arritur tek fitimi i tatueshëm.

Kutia 11 deri në 15 të deklaratës së tatimit në te ardhurat e korporatave janë rregullime në të ardhura. Kutia 18 deri 26 janë rregullime në shpenzime. Për secilin rregullim është dizajnuar tabela. Ju duhet të përgatisni të gjitha tabelat që aplikohen në biznesin tuaj. Aty ku nuk kërkohen rregullime, thjesht shkruani “zero” në atë kuti. **Sigurohuni se e keni lexuar secilën pjesë që lidhet me secilën tabelë dhe me kujdes përcaktoni nëse aplikohet për gjendjen tuaj apo jo.**

### **Rregullimet mund të jenë pozitive ose negative:**

Aty ku rregullimet janë negative, duhet t’i vendosni ato ne kllapa. Për shembull, nëse keni rregullim negativ prej 500€ për shpenzimet e përfaqësimit, duhet të shkruani (500) në kutinë 19 të deklaratës.

## IDENTIFIKIMI

**Kutia 1-** Periudha Tatimore është viti kalendarik per te cilin i deklaroni te ardhurat (psh. 2005)

**Kutia 2-** Numri serik është i parashtypur. Mos shkruani në kutinë 2.

**Kutia 3-** Për korporatat, do të jetë numri regjistruar i biznesit që fillon me “8”apo me “7.” Për OJQ-të, do të jetë numri i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të OJQ-ve që fillon me “5”.Numri që fillon me 5 (pesë) duhet të shenohet edhe nga OJQ-të me status të përfitimit publik

**Kutia 4-** Të shenohet emërtimi i biznesit p.sh. NTP “KASTRIOTI”

**Kutia 5-** Të shenohet adresa e biznesit vetëm nëse biznesi deklaron për herë të parë apo nëse e ka ndërruar adresën që e ka shenuar në deklarinimin e mëhershëm.

**Kutia 6 -** Të shenohet emri dhe mbiemri i pronarit të biznesit.

**Kutia 7 -** Duhet të shenohet emri i menagjerit.

**Kutia 8 -** Të shenohet emri i personit i cili bën udhëheqjen e regjistrimeve kontabël.

**Kutia 9** - **Ndryshimi në deklaratë.** Nëse bëni ndonjë gabim kur të përgatitni deklaratën tuaj, duhet të dorëzoni një deklaratë ndryshuese (korrigjuese). Kutia 9 e deklaratës ka 3 kutiza. Gjithsesi vendos “x” në kutizën që përshkruan llojin e ndryshimit.

“**Shtesë**” – Nëse tatimpaguesi ka deklaruar njëherë, mirpo për periudhën e njëjtë deklaruese dëshiron të bëjë deklaram shtesë, atëherë plotësohet edhe një formë tjetër me të gjitha shenimet .Teknologjia Informative do t’i bashkojë(mbledhë) shenimet nga forma e pare dhe e dytë, dhe do të formojë një formë të vetme

“**Korigjim**” - Nëse tatimpaguesi ka deklaruar njëherë, por formën e dorëzuar më herët dëshiron ta korigjojë, atëherë plotësohet edhe një formë tjetër ashtu si është dashur të jetë forma e parë. Teknologjia Informative do t’i përpunoj të dhënat e formës së re, kurse forma e vjetër do të anulohet.

“**Vetëm pagesë**” - Nëse tatimpaguesi ka deklaruar mirpo në kohën e deklarimit nuk ka pasur mundësi ta bëj tërë pagesën, atëherë tatimpaguesi duhet të plotësoj një formë tjetër dhe në atë formë duhet të shenohet (përveq të dhënave elementare) vetëm shuma e mjeteve që paguhet

**Kutia 10-** **Neto fitimi /humbjet sipas Pasqyrës Financiare** vjen nga Pasqyra e të Ardhurave, nga një herë quhet “Pasqyra e Fitimit apo Humbjes”. Nëse keni humbje neto në vend të fitimit neto në pasqyrën tuaj të të ardhurave, vendoseni shumën mbrenda kllapave. Për shembull, nëse keni humbjen neto prej 10,000 € në pasqyrën tuaj të të ardhurave, shkruani (10,000 €) në kutinë 10 të deklaratës suaj.

Kompanitë e sigurimeve qe **aktiviteti i tyre kryesor** eshte sigurimi i jetes i prones ose reziqeve tjera me rastin e plotesimit te deklarates tatimore ne kutin dhjete [10] te deklarates tatimore (fitimi neto financiar),duhet te vendosni Zero [0]

## RREGULLIMET NË TË ARDHURA

Rregullimet do të rrisin ose do të zvogëlojnë të ardhurat. Nëse rregullimi zvogëlon të ardhurat, vëjeni shumën mbrenda kllapave.

**Kutia 11-** **Të Ardhurat me Burim të Huaj (Kompletoni Tabelën A).** Si banor i Kosovës, ju duhet të raportoni të ardhurat tuaja nga të gjitha burimet, të dyja si ato mbrenda Kosovës ashtu edhe ato jashtë saj.

Të gjitha të ardhurat nga shtetet tjera duhet të tregohen në euro. Nëse shteti i jashtëm ku zhvilloni biznes apo nga i cili ju merrni të ardhura shfrytëzon valutë tjetër nga euroja, ju duhet të bëni konvertimin në euro. Konvertimi duhet të bëhet duke shfrytëzuar normën e konvertimit të aplikuar në ditën kur është pranuar pagesa apo, nëse shuma është paguar në kohë të ndryshme gjatë vitit, mund të përdorni një normë mesatare vjetore. Duhet të jeni të përgatitur të demonstroi se si e keni llogaritur normën mesatare vjetore. Janë dy mënyra në sigurimin e normës së aplikueshme të këmbimit. Mund ta siguron nga burimi siç është interneti nëse ka në dispozicion. Nëse nuk ka, duhet ta siguron nga Banka Qendrore e shtetit të huaj që e aplikon. Nëse për shembull, shteti i jashtëm është Zvicra dhe valuta është Franga zvicerane, mund ta shfrytëzoni normën e këmbimit në internet.

Në anën tjetër, nëse shteti i huaj është Shqipëria dhe valutë në Shqipëri është Leku, duhet që normat e këmbimit t'i siguroni nga Banka Qendrore e Shqipërisë dhe të merrni provë se normat që keni përdorur janë të sakta.

**Tabela A:** Në kolonën 1, kutia e parë, duhet të raportoni **totalin e të ardhurave neto** nga çdo njësi e përhershme jashtë Kosovës. Shuma duhet të shprehet në euro.

Të ardhurat neto nënkupton të ardhurat minus shpenzimet e lejueshme. Për të përcaktuar se cilat shpenzime nuk janë të lejueshme apo cilat kërkojnë rregullime, ju lutemi referohuni tabelave të identifikuar në kutitë 18 deri 26 të deklaratës së tatimit në të ardhurat e korporatave. Për të llogaritur shumën totale të të ardhurave neto në keto tabela, duhet të përgatitni nën-tabelat me të gjitha hollësitë. Mos ia bashkëngjitni këto nën-tabela deklaratës suaj por mbani në dispozicion për rishikim nga inspektorët tatimor.

Në kolonën 1, kutia e dytë, duhet të raportoni totalin e të ardhurave nga dividendat të pranuar nga të gjitha shtetet e jashtme. Shuma duhet të shprehet në euro. Për të llogaritur shumën totale, duhet të kompletioni nën-tabelën në hollësi të cilën duhet ta mbani në dispozicion për rishikim nga inspektori tatimor.

Në kolonën 1, kutia e tretë, duhet të raportoni totalin e të ardhurave nga kamata të pranuar nga të gjitha shtetet e jashtme. Shuma duhet të shprehet në euro. Për të llogaritur shumën totale, duhet të kompletioni nën-tabelën në hollësi të cilën duhet ta mbani në dispozicion për rishikim nga inspektori tatimor.

Në kolonën 1, kutia e katërt, duhet të raportoni **totalin e të ardhurave neto** të çfarëdo veprimtarie biznesi ndryshe nga njësit e përhershme jashtë Kosovës dhe çfarëdo lloji tjetër të të ardhurave nga çfarëdo shteti i jashtëm. Si shembull mund të jenë të ardhurat nga qiraja e pasurisë së patundshme. Të ardhurat neto nënkupton neton nga shpenzimet e lejueshme. Proces i ngjashëm sikurse për kutinë 1.

Në kolonën 2, kutia 1 deri 4, duhet të raportoni shumat e përfshira në pasqyrën tuaj finaciare. Për të llogaritur shumat e përfshira në pasqyrën financiare, duhet të përdorni mënyrën e njëjtë sikurse e keni përdorur në kolonën 1, kuti pas kutie, dhe duhet t'i mbani të gjitha nën-tabelat që i keni përgatitur, për rishikim nga inspektori tatimor.

Kolona 3 është ndryshimi në mes të kolonës 1 dhe 2. Totali i kolonës 3 (kutia 5) është shuma që duhet ta raportoni në kutinë 11 të deklaratës. Nëse shuma është negative, vendose në kllapa.

**Kutia 12- Arkëtimi i borxhit të keq (Kompletoni tabelën B).** Kolonat 1 deri 5 të tabelës B janë vetë-sqaruese. Në kolonën 6, duhet të përfshini të gjitha shumat të arkëtuara gjatë periudhës tatimore madje edhe nëse borxhi është fshirë në periudhat e mëparshme. Në kolonën 7, bilanci i borxhit të keq të fshirë do të jetë shuma në kolonën 3, minus shuma e arkëtuar në vitin tatimor nga kolona 6, minus çdo shumë e arkëtuar përpara periudhës tatimore. Ju duhet t'i mbani regjistrimet e hollësishme të borxheve të këqija të fshira dhe borxheve të këqija të arkëtuara. Borxhliu duhet të identifikohet qartë me emër dhe numrin e biznesit.

Rregullimi në kutinë 6 të tabelës B duhet të vendoset në kutinë 12 të deklaratës.

**Kutia 13- Rregullimet në përfitimet kapitale apo humbjeve kapitale (Kompletoni tabelën C).** Tabela C përfshinë 5 nën-tabela të quajtura zona (a) deri (e). Këto nën-tabela

do t'u lejojnë të llogarisni rregullimin e pasqyrës financiare për secilin lloj të asetit. **Duhet së pari të kompletini këto nën-tabela përpara se të kompletini tabelën C.**

Totali i kolonës 6 i tabelës C duhet të futet në kutinë 13 të deklaratës nëse është përfitim kapital. Nëse është humbje kapitale, duhet të vendoset në kutinë 25 të deklaratës.

**Zona (a) - Pasuria e patundshme përveç aseteve të zhvleresueshme të Kategorisë 1.**

Për të llogaritur fitimin kapital në pasurinë e patundshme, duhet së pari të përcaktoni çmimin e shitjes, çmimin e blerjes/ndërtimit dhe koston e përmirësimit. **Çmimi i shitjes** (kolona 3) është çmimi i treguar në kontratën e shitjes. **Çmimi i blerjes/ndërtimit** (kolona 5) duhet të llogaritet në të njëjtën mënyrë sikurse çmimi i blerjes/ndërtimit të aseteve të amortizueshme të kategorisë 1 [referohuni tabelës J(a) zonat 2 ose 3. **Kostoja e përmirësimit** (kolona 6) duhet të përfshijë vetëm shpenzimet që lidhen me punën renovuese, ndërtimin e një shtese, riparimin thelbësor apo zëvendësimin thelbësor. Shpenzimet e mirëmbajtjes nuk përfshihen. **“Puna renovuese”** do të mund të ndryshonte dukjen e përgjithshme të pronës. **“Ndërtimi i një shtese”** do të ishte sikur t'i shtohet një kat i ri ndërtesës. **“Riparimi thelbësor”** do të ishte sikur të ribëhej i tërë kulmi i një ndërtese. **“Zëvendësimi thelbësor”** do të ishte zëvendësimi i sistemit hidraulik. Zëvendësimi i disa tjegullave në kulm dhe zëvendësimi i disa duqeve (rubinetëve) janë shpenzime të mirëmbajtjes dhe nuk janë të përfshira në koston e përmirësimit. **Shpenzimet nga shitja** (kolona 7) janë shpenzimet që kanë dalur me shitjen e pasurisë së patundshme dhe mund të përshfshijnë gjëra të tilla sikurse janë tarifatat e ngarkuara nga agjentët e pasurisë së patundshme dhe avokatët. Sa i përket zhvlerësimit të **akumuluar** (kolona 8), kur të jetë shitur aseti i zhvlerësueshëm, zhvlerësimi i marrë si shpenzim është që nga realizimi i blerjes së asetit dhe duhet të zbritet nga shpenzimet totale. Përfitimi (humbja) kapital (kolona 9) është ndryshimi në mes të çmimit të shitjes (kolona 3) dhe shpenzimeve (kolona 5 + kolona 6 + kolona 7 - kolona 8). Çdo gjë duhet të dokumentohet në tërësi dhe dokumentet përkrahëse sikurse janë kontratat dhe faturat duhet të mbahen për rishikim. Verifikimi i tërthortë mund të bëhet nga Administrata Tatimore tek të gjitha palët e përfshira.

Shumat e raportuara në pasqyrën financiare për secilën pjesë të pasurisë së patundshme të shitur (kolona 10) duhet të llogariten në mënyrë të njëjtë sikurse përfitimi (humbja) kapital i përshkruar në paragrafin e sipërm dhe se duhet të dokumentohen në tërësi.

Rregullimi në pasqyrën financiare (kolona 11) është ndryshimi në mes të kolonës 9 dhe 10. Totali i kolonës 11 duhet të raportohet në kolonën 1 të tabelës C. Nëse totali në kolonën 11 është humbje, vendos shumën mbrenda kllapave.

**Zona (b) – Përfitimi (humbja) kapitale në asetet e zhvleresueshme të kategorisë 1.**

Çmimi i shitjes (kolona 3) vjen nga kontrata. Çmimi i blerjes/ndërtimit (kolona 5) dhe kostoja e përmirësimit (kolona 6) duhet të llogariten në mënyrë të njëjtë sikurse për tabelën J(a) zonat 2 apo 3 dhe 4 respektivisht. Shpenzimet nga shitja (kolona 7) janë shpenzimet që në të vërtetë kanë lindur për shitjen e asetit. Shpenzimet e tilla mund të jenë provizionet e paguara për avokatin apo agjentin e pasurisë së patundshme. Zhvlerësimi i akumuluar (kolona 8) e marrë që kur blerja e asetit është realizuar dhe duhet të zbritet nga shpenzimet. Përfitimi apo humbja është ndryshimi në mes të shumës së shitjes në kolonën 3 dhe totali i shpenzimeve (kolonat 5+6 +7-8).

**Zona (c) – Përfitimi (humbja) kapitale në aksione.** Është e qartë përveç kolonës 8. Nëse shuma në kolonën 6 është përfitim, tarifa e ndërmjetësimit (brokerit) do ta zvogëlojë përfitimin dhe llogaritja e përfitimit/humbjes pas shpenzimeve (kolona 8) duhet të jetë

kolona 6 minus kolona 7. Kur të jetë zbritur tarifa e ndërmjetësimit, rezultati mund të jetë humbje. Nëse shuma në kolonën 6 është humbje, tarifa e ndërmjetësimit do të rrisë humbjen dhe llogaritja e kapitalit (kolona 8) duhet të jetë kolona 6 plus kolona 7. **Mbani në mend se duhet të vendosni shumën mbrenda kllapave aty ku humbja është vënë.**

Shumat e raportuara në pasqyrat financiare (kolona 9) duhet të kalkuloohen në baza të njëjta sikurse përfitimi (humbja) kapitale e përshkruar më sipër. Dokumentacioni i tërësishëm duhet të jetë në gatishmëri.

Rregullimi në pasqyrat financiare (kolona 10) është ndryshimi në mes të kolonës 8 dhe 9. Totali i kolonës 10 duhet të raportohet në kolonën 3 të tabelës C. Nëse totali në kolonën 10 është humbje, vendose shumën mbrenda kllapave.

**Zona (d) – Përfitimi (humbja) kapital në obligacione, obligacione te pagarrantuara dhe tituj tjerë të ngjashëm.** Informatat për të plotësuar kolonat 1 deri 7 duhet të sigurohen nga lëshuesi i tyre.

Shumat e raportuara në pasqyrat financiare (kolona 8) duhet të llogariten në baza të njëjta sikurse përfitimi (humbja) kapital që u përshkrua më sipër. Dokumentacioni i tërësishëm duhet të jetë në gatishmëri.

Rregullimet në pasqyrat financiare (kolona 9) është ndryshimi në mes të kolonës 7 dhe 8. Totali i kolonës 9 duhet të raportohet në kolonën 4 të tabelës C. Nëse totali në kolonën 9 është humbje, vendose shumën mbrenda kllapave.

**Zona (e) – Përfitimi kapital në shndërrimin e pavullnetshëm.** Ju duhet të llogaritni **përfitimin kapital** kur paratë të jenë marrë nga sigurimet për pasurinë e shkatërruar apo të dëmtuar substancialisht dhe pasuria nuk është zëvendësuar mbrenda 2 viteve me pasuri të karakterit apo të natyrës së njëjtë. **Nuk lejohet humbje kapitale meqë pagesa e marrë ka qenë për kompenzim të humbjeve të shkaktuara.**

Kolona 1, 2 dhe 3 të zonës (e) janë të qarta në vetvete. Çmimi i blerjes/ndërtimit (kolona 4) dhe kostoja e përmirësimit (kolona 5) duhet të llogariten si në rastin tabelës J(a) zonat 2 apo 3 dhe 4 repektivisht. Kompenzimi (kolona 6) është shuma e marrë nga sigurimi. Përfitimi (kolona 7) është rezultat i kompenzimit në kolonën 6 minus blerja/ndërtimi dhe shpenzimet e përmirësimit në kolonën 4 dhe 5. **Nëse rezultati është negativ, vendos 0 në kolonën 7 pasi që humbja kapitale nuk është e lejueshme. Nëse aset i është zëvendësuar mbrenda 2 viteve, vendos 0 në kolonën 7.**

Në kolonën 8 vendosni shumën e raportuar në pasqyrat financiare nëse keni.

Rregullimi i pasqyrave financiare (kolona 9) është ndryshimi në mes të kolonës 7 dhe 8. Totali i kolonës 9 duhet të raportohet në kolonën 5 të tabelës C. Nëse totali në kolonën 9 është humbje, vendosni shumën mbrenda kllapave.

**Kutia 14**- Rregullimi në dividendë (*Kompletoni tabelën D*). Nëse dividendat e pranuar nga kompania rezidente e Kosovës që ka paguar tatimin në fitim apo tatim net e ardhura te korporatave në Kosovë është përfshirë si e ardhur në pasqyrat financiare, atëherë është i nevojshëm rregullimi. Qëllimi është të parandalohet tatuarja e dyfishtë. Kolonat 1 deri 5 janë të qarta në vetvete. Normalisht, rezultati duhet të jetë 0 apo negativ. Nëse rezultati është negativ, duhet të vendoset mbrenda kllapave. Shuma duhet të raportohet mbrenda kllapave në kutinë 14 të deklaratës.



**Kutia 15-** Të ardhura/përfitime tjera (*Kompletoni tabelën E*). Ju duhet të përfshini çdo lloj të të ardhurave/përfitimeve të rregullta apo jo të rregullta që nuk janë përfshirë në pasqyrat financiare. Përfitimet mund të rrjedhin nga shpërndarja e pasurisë, likuidimi, riorganizimi, transferi i çmimit, etj. (Referohuni neneve 21 deri 24 të rregullores 2002/3dhe neni 22-26 të Rr.2000/51). Tabela E është e qartë në vetvete. Rregullimi në pasqyrat financiare (kolona 3) duhet të futet në kutinë 15 të deklaratës.

**Kutia 16-** Është e qartë në vetvete.

**Kutia 17-** Nëse shuma në kolonën 10 është fitim, fitimi në kutinë 17 normalisht do të mund të rritej sikur totali i rregullimit në të ardhura normalisht do të mund të ishte pozitiv. Nëse shuma në kolonën 10 ka qenë humbje, humbja normalisht do të mund të zvogëlohej, apo tërësisht të eliminohej, apo të ngarkohej në fitim.

## RREGULLIMET NË SHPENZIME

Rregullimet do të rrisin ose do të zvogëlojnë shpenzimet. Nëse rregullimi zvogëlon shpenzimet, vëjeni shumën mbrenda kllapave.

**Rregullimet në shpenzime nuk do të bëhen për kompanit e sigurimeve aktiviteti kryesor i të cilave është sigurimi ose risigurimi i jetes, pronës ose reziqeve tjera.**

**Kutia 18-** Shpenzimet e palejuara – (*Kompletoni tabelën F*). Shuma e raportuar në secilën kolonë duhet të rrjedhë nga nën-tabelat që duhet të jenë në dipozicion (gatishmëri) për rishikim nga inspektorët tatimor. Dokumentet përkrahëse (kontratat, faturat, etj.) duhet poashtu të jenë në dispozicion. Kostoja e blerjes/ndërtimit të aseteve të zhvlerësueshme amortizueshme dhe kostoja e blerjes së aseteve të zhvlerësueshme gjate periudhes tatimore (kolona 3 e tabelës F) vijnë nga disa burime. Kostoja e blerjes dhe ndërtimit të aseteve të amortizueshme vjen nga tabela J(a) kolonat 2 dhe 3; tabela J(b) kolonat 2 dhe 3; tabela J(c) kolonat 2 dhe 3. Kostoja e blerjes së aseteve të zhvlerësueshme vjen nga kontratat.

Shumat e raportuara në pasqyrat financiare duhet të llogariten dhe zbriten nga totali në kolonën 7 për të arritur tek rregullimi. Rregullimi në pasqyrat financiare duhet të raportohet në kutinë 18 të deklaratës.

**Kutia 19-** Shpenzimet e përfaqësimit (*Kompletoni tabelën G*). Shpenzimet e përfaqësimit janë të gjitha shpenzimet që lidhen me ngritjen e biznesit apo prodhimeve të tij dhe përfshijnë shpenzimet për publikime, reklama, argëtim dhe shpenzime tjera të ngjashme. Tabela G është e qartë në vetvete. Shuma maksimale e lejuar është deri në 2% e totalit të qarkullimit. Nëse shuma e përfshirë në pasqyrat financiare (kutiza [b] e tabelës G) është më e lartë se shuma e lejuar (kutiza [a] e tabelës G), vendoseni shumën në kutizën [c] të tabelës G në kutinë 19 të deklaratës. Nëse shuma e regjistruar në pasqyrat financiare (kutiza [b] e tabelës G) është më e ulët se shuma e lejuar në kutizën [a] të tabelës G, vendoseni 0 në kutinë 19 të deklaratës.

**Kutia 20-** Fondet rezervë (*Bankat duhet të kompletojnë tabelën H(a) dhe tabelën H(b)*). (*Të gjitha bizneset përveç banakve duhet të përgatisin tabelën H(b)*).

Vetëm bankat kanë të drejtë të rezervojnë fonde dhe vetëm për asetet e dyshimta. Rregullimi për banka do të jetë ndryshimi në mes totalit të lejuar në kolonën 6 të tabelës

H(a) dhe shuma totale e regjistruar në pasqyrat financiare për të gjitha fondet rezervë, përfshirë asetet e dyshimta (kolona 2 e tabelës H(b)). Rregullimi duhet të raportohet në kutinë 20 të deklaratës.

**Të gjitha bizneset përveç bankave** nuk kanë të drejtë për asnjë fond rezervë. Nëse ndonjë fond rezervë është përfshirë në pasqyrat financiare, duhet t'i vendosni në listë ato në kolonën H(b). në kolonën 1, vendosni natyrën e secilit fond rezervë të përfshirë në pasqyrat financiare. Në kolonën 2, vendosni shumën. Rregullimi do të jetë totali i kolonës 2. Kjo shumë duhet të vendoset në kutinë 20 të deklaratës.

**Kutia 21- Pagesat për Personat e lidhur (Kompletoni tabelën I).** Përgatitni pasqyrat e hollësishme për secilin lloj të pagesës që përfshinë emrin e përfituesit, raportin (marrëdhënien), shumën e paguar sipas pasqyrave financiare dhe çmimin e tregut apo vlerën e hapur të tregut për llojin e pagesës. Shuma totale e paguar sipas pasqyrave financiare për secilin lloj të shpenzimeve duhet të regjistrohet në kolonën 1 të tabelës I. Në kolonën 2, vendosni çmimin e tregut për kompenzim/honorare dhe vlerën e hapur të tregut për të gjitha shpenzimet tjera. Ndryshimi (kolona 3) është rregullimi për secilin lloj të pagesës. Totali i tabelës I, kolona 3 duhet të vendoset në kutinë 21 të deklaratës.

**“Personat e lidhur”** është e definuar në nenin 1 të rregullores 2002/3 dhe 2004/51. **Çmimi i tregut** për kompenzim/honorare është çmimi që do të kishit paguar për llojin e njëjtë të shërbimeve të kryera nga një person i pavaruar. **Vlera e hapur e tregut** për llojet tjera të pagesës është çmimi që personi i lidhur do të kishte paguar nëse shërbimet apo mallrat marrë nga burimet e pavarura. Për shembull, për hua, shuma do të ishte shuma e huasë shumëzuar me përqindjen e ngarkuar nga banka. Për qira, shuma do të mund të ishte shuma që personi i lidhur do të kishte paguar për llojin e njëjtë të objekteve të një pronari të pavarur.

**Kutia 22- Zhvleresimi (Kompletoni tabelën J).**

Për të arritur shumën totale të zhvleresimit të lejuar, duhet të plotësoni tabelën J(a) për kategorinë 1 të aseteve, tabelën J(b) për kategorinë 2 të aseteve dhe tabelën J(c) për kategorinë 3 të aseteve. Pastaj duhet të bëni përmbledhjen e rezultateve të të tri kategorive në tabelën J. Totali i regjistruar në pasqyrat financiare duhet të zbritet nga totali i të tri tabelave dhe ndryshimi (rregullimi) duhet të vendoset në kutinë 22 të deklaratës. Ndryshimi mund të jetë pozitiv ose negativ. Nëse është negativ, vëjeni shumën mbrenda në kllapa.

Shpenzimet e zhvleresimit të regjistruara në pasqyrat financiare dhe shpenzimet e zhvleresimit të lejueshme për qëllime të tatimit në te ardhura te korporatave mund të jenë shuma të ndryshme. Për qëllime të tatimit në te ardhura te korporatave, ekzistojnë 3 kategori të zhvleresimit. **Kategoria 1** është për ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore. **Kategoria 2** është për automobilat, kamionat e lehtë, mjetet e renda për transport, buldozheret, gërmuesit e dheut, kompjuterët, pjesët periferike dhe pajisjet tjera procesuese, mobiliet e zyres dhe pajisjet e zyres, instrumentet, sende të ndryshme dhe pjesë tjera dytësore (aksesorë). **Kategoria 3** është për uzinat, vagonat dhe lokomotivat të shfrytëzuara në transportin hekurudhor, aeroplanët, anijet dhe të gjitha asetet tjera të trupëzuara.

**Lexoni nenin 1.1 të rregullores.Nr.2005/51.**

**Kategoria 1 – Tabela J (a):** Secili aset i kategorisë 1 duhet të ketë llogarinë e vet të ndarë.

Në kolonën 1 të tabelës J(a) të këtij viti, vëjeni shumën nga kolona 7 e tabelës J(a) të periudhës tatimore paraprake (viti i kaluar).

Nëse biznesi ka qene ne TAK edhe para periudhes tatimore 2006, vleren neto (e pazhvleresuar) te secilit aset ne fillim te 2006 barteni në zonën 1 të tabelës J(a).

Nëse biznesi ka hyrë në TAK real gjatë periudhës tatimore 2006, plotësojeni tabelën Zona 1 (Vlera e pazhvleresuar në fillim të vitit), kurse shumën nga kolona 6 të së njëjtës tabelë barteni në zonën 1 të tabelës J(a).

Në kolonën 2, vëjeni shumën e kolonës 7 të zonës 2. Në kolonën 3, vëjeni shumën e kolonës 8 të zones 3. Në kolonën 4, vëjeni shumën totale të kolonës 4 të zonës 4 vetëm nëse është më e lartë se shuma e kolonës 3 të zonës 4. Nëse jo, vëjeni 0. Në kolonën 5, vëjeni totalin që përfshijnë kolonat 1 deri 4. Në kolonën 6, llogaritni zhvleresimin duke e shumëzuar shumën në kolonën 5 me 5%. Në kolonën 7, llogaritni vlerën e pazhvleresuar në fund të vitit duke zbritur shumën në kolonën 6 nga shuma në kolonën 5.

**Shuma e regjistruar në kolonën 6 të tabelës J(a) duhet të raportohet në kutinë 1 të kolonës 3 të tabelës J (Përmbledhja e kategorive 1,2 dhe 3 e aseteve të amortizueshme).**

**Vlera per llogaritjen e zhvleresimit te aseteve të amortizueshme të kategorisë 1, per periudhen tatimore 2006 (zona 1).** Kjo zbatohet në asetet të blera para vitit tatimor per te cilin deklaroni vetëm për bizneset që kanë hyrë në tatimin në te ardhurat e korporatave gjatë periudhës tatimore 2006. Për të përcaktuar vlerën e pazhvleresuar të këtyre aseteve në fillim të vitit 2006, duhet të të kompletioni nën-tabelën **zonën 1**. Në kolonën 1 të zonës 1, shkruani emrin e asetit. Në kolonën 2, shkruani vitin e blerjes. Në kolonën 3, vendosni numrin e viteve që kur është bërë blerja ( p.sh.2006 – viti i regjistruar në kolonën 2). Në kolonën 4, vendosni vlerën e asetit në kohën e blerjes. Në kolonën 5, vendosni zhvleresimin e akumuluar duke e shumëzuar vlerën e blerjes (kol.4) me përqindjen e amortizimit (5%) dhe me numrin e viteve që nga blerja (kol.3). Në kolonën 6, vendosni vlerën e pazhvleresuar duke zbritur zhvleresimin e akumuluar (kol.5) nga vlera e asetit në kohën kur është blerë (kol.4).

Per qellime te zhvleresimit vlera e asetit duhet te jete e dokumentuar me dokumentet percjellese.

Vleresimi i aseteve per qellime te tatimit ne prone nuk pranohet per qellime te tatimit ne te ardhura te korporatave.

Secili aset i kategorisë 1 i cili nuk është blerë gjatë vitit tatimor 2006 duhet të regjistrohet në nën-tabelën zona 1. Vendosni vlerën totale të kolonës 6 në kolonën 1 të tabelës J(a).

**Kostoja e blerjes së aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 1 (zona 2).** Kjo zbatohet në asetet e blera gjatë vitit. Për të përcaktuar çmimin e blerjes, duhet të përgatitni nën-tabelën **zona 2**. Në kolonën 1, shkruani emrin e asetit. Në kolonën 2, shkruani çmimin e blerjes. Në kolonën 3, shkruani koston e navllos (transportimit). Në kolonën 4, shkruani koston e sigurimit nëse keni. Në kolonë 5, kostoja e blerjes është totali i kol. 2,3 dhe 4. Në kolonën 6, shkruani datën kur është vënë aseti në shërbim. Në kolonën 7, vendosni shumën e kolonës 5 vetëm nëse aseti është vënë në shërbim në vitin tatimor 2006. nëse aseti nuk është vënë në shërbim në vitin tatimor 2006 per te cilin deklaroni, vendosni 0. Totali i kolonës 7 të zonës 2 duhet të raportohet në kolonën 2 të tabelës J(a).

Në qoftë se shumat për transport dhe sigurim janë lejuar të kapitalizohen në kolonat 3 dhe 4 dhe janë përfshirë në shpenzimet në pasqyrat financiare, duhet të bëhet rregullimi në tabelën M.

**Çmimi i ndërtimit i aseteve të zhleresueshme të kategorisë 1 (zona 3).** Nëse aset është ndërtuar në vend se të blehej, duhet të përgatitni nën-tabelën **zona 3** për të përcaktuar çmimin e ndërtimit. Në kolonën 1, shkruani emrin e asetit. Në kolonën 2, shkruani koston e materialit. Në kolonën 3, shkruani shumën e tatimeve të paguara në materialin e shfrytëzuar për ndërtim. Në kolonën 4, shkruani shumën e detyrimeve (doganore) të paguara në materialet e shfrytëzuara për ndërtim. Në kolonën 5, shkruani shumën e kamatës së paguar në paratë e huazuara për të blerë materialet. Në kolonën 6, totali i koston së ndërtimit është totali i kolonave 2,3,4 dhe 5. Në kolonën 7, shkruani datën e vënies së asetit në shërbim. Në kolonën 8, vendosni shumën e kolonës 6 vetëm nëse aset është vënë në shërbim në vitin tatimor 2006. Nëse aset nuk është vënë në shërbim gjatë vitin tatimor 2006, vendosni 0 në kolonën 8. Totali i kolonës 8 duhet të raportohet në kolonën 3 të tabelës J(a).

Të gjitha shpenzimet e materialit, tatimet, detyrimet doganore dhe kamata duhet të përmblihen dhe i tërë dokumentacioni përkrahës duhet të jetë në dispozicion për t'u rishikuar nga inspektorët tatimor. Shpenzimet që nuk janë të përkrahura (mbështetura) me dokumentacion nuk do të lejohen gjatë kohës së kontrollit.

Në qoftë se shumat për tatimet e paguara, detyrimet doganore të paguara dhe kamatën e paguar janë lejuar të kapitalizohen në kolonat 3,4 dhe 5 dhe janë përfshirë në shpenzimet në pasqyrat financiare, duhet të bëhet rregullimi në tabelën M.

**Shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 1 (zona 4)** duhet të kapitalizohen nëse ato paraqesin më tepër se 5% të balancit total në llogarinë në fillim të vitit 2006. Për të përcaktuar a duhet kapitalizuar, duhet të përgatitni nën-tabelën tuaj për të gjitha shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit për të gjitha asetet e kësaj kategorie. Kjo nën-tabelë duhet të identifikojë asetin, numrin kontraktues të faturës/mirëmbajtjes, kryesin e shërbimeve, datën e shërbimit, dhe shumën e paguar apo të pagueshme. Totali për vitin për të gjitha asetet e kësaj kategorie duhet të regjistrohen në kolonën 1 të zonës 4. Në kolonën 2 të zonës 4, shkruani vlerën e pazhvleresuar në fillim të vitit (nga kolona 1 e tabelës J(a)). Në kolonën 3, llogaritni 5% të kolonës 2. Nëse shuma në kolonën 1 tejkalon shumën në kolonën 3, vendosni shumën tepërcen në (kolona 4) në kolonën 4 të tabelës J(a). Nëse jo, vendosni 0 në kolonën 4 të tabelës J(a).

Në qoftëse shumat e lejuara të kapitalizohen janë përfshirë në shpenzime në pasqyrat financiare, duhet të bëhen rregullime në tabelën M.

**Kategoria 2 – Tabela J(b):** Të gjitha asetet që lidhen me këtë kategori duhet të bashkohen.

Në kolonën 1 të tabelës J(b) të kësaj periudhe tatimore (2006), vendosni shumën nga kolona 8 e tabelës J(b) ,të periudhës së kaluar tatimore(viti paraprak 2005). Në kolonën 1 të tabelës J(b) të kësaj periudhe tatimore (2006), nga kolona 8 e tabelës J(c), të periudhës së kaluar tatimore(viti paraprak 2005) vendosni shumën e aseteve si p.sh. paisjeve për bartjen e dheut, buldozhereve, gërmueseve të dheut si dhe mjeteve të tjera të renda, të cilat asetë gjatë periudhës tatimore 2005 kanë bërë pjesë në kategorinë e tretë sipas

Rregullores Nr.2004/51, dhe prej periudhes tatimore 2006 do te bejne pjese ne kategorine e dyte sipas Rregullores Nr.2005/51. Në kolonën 2, vendosni shumën e kolonës 8 të zonës 6. Në kolonën 3, vendosni shumën e kolonës 9 të zonës 7. Në kolonë 4, vendosni shumën e kolonës 4 të zonës 8 vetëm nëse është më e lartë se shuma e kolonës 3 të zonës 8. Nëse jo, vendosni 0. Në kolonën 5, vendosni totalin e kolonës 3 të zonës 9. Në kolonën 6, vendosni totalin e kolonave 1 deri 4, përfshirë, minus shuma e kolonës 5. Në kolonën 7, llogaritni zhvleresimin duke shumëzuar shumën në kolonën 6 me 20%. Në kolonën 8, llogaritni vlerën e pazhleresuar në fund të vitit duke zbritur shumën në kolonën 7 nga shuma në kolonën 6.

**Shuma e regjistruar në kolonën 7 të tabelës J (b) duhet të raportohet në kutinë 2 të kolonës 3 të tabelës J (Përmbledhja e kategorisë 1,2 dhe 3 e aseteve të amortizueshme).**

**Vlera per llogaritjen e zhvleresimit te aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 2, per periudhen tatimore 2006 (zona 5).** Kjo zbatohet tek asetet e blera perpara vitit tatimor 2006 (periudhes tatimore 2006), vetëm për bizneset që kanë hyrë në tatimin në te ardhura te korporatave gjatë periudhës tatimore 2006 per te cilen deklaroni. Për të përcaktuar vlerën e pazhleresuar të këtyre aseteve në fillim të vitit 2006,duhet të kompletioni nën-tabelën **zona5**. Në kolonën 1 të zonës 5 shkruani emrin e asetit. Në kolonën 2, shkruani vitin e blerjes. Në kolonën 3, vendosni numrin e viteve që nga blerja ( psh. 2006 minus viti i regjistruar në kolonën 2). Në kolonën 4, vendosni vlerën e asetit në kohën e blerjes. Në kolonën 5, vendosni zhvleresimin e akumuluar duke e shumëzuar vlerën e blerjes (kol. 4) me përqindjen e amortizimit (20%) dhe me numrin e viteve që nga blerja (kol.3). Në kolonën 6, vendosni vlerën e pazhleresuar në fillim të vitit duke zbritur zhvleresimin e akumuluar (kol.5) nga vlera e asetit në kohën kur është blerë (kol.4).

Per qellime te zhvleresimit nuk do te pranohet vlera momentale e asetit bazuar ne vleren e tregut te asetit apo ndonje metode tjeter te vleresimit, por vlera e percaktuar bazuar ne shpenzimet reale te ndodhura dhe te dokumentuara.

Vleresimi i aseteve per qellime te tatimit ne prone nuk pranohet per qellime te tatimit ne te ardhura te korporatave.

Secili aset i ketegorisë 2 që nuk është blerë gjatë vitit 2006 duhet të regjistrohet në nën-tabelën zona 5. Vendosni vlerën totale të kolonës 6 të zonës 5 në kolonë 1 të tabelës J(b).

**Kostoja e blerjes së aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 2 (zona 6).** Nëse aseti është blerë kurdo gjatë vitit 2006, duhet të regjistrohet çmimin e blerjes në kolonën 2 të tabelës J(b). Për të përcaktuar çmimin e blerjes, duhet të përgatitni nën-tabelën **zona 6**. Në kolonën 1, shkruani emrin e asetit. Në kolonën 2, shkruani çmimin e blerjes. Në kolonën 3, shkruani koston e navllos (transportit). Në kolonën 4, shkruani koston e sigurimit nëse këni. Në kolonën 5, kostoja e blerjes është totali i kol.2, 3 dhe 4. Në kolonën 6, shkruani shumën e kolonës 5 vetëm nëse është e barabartë apo më e lartë se 1,000 € Nëse jo, shkruani 0. Në kolonën 7, shkruani datën kur është vënë aseti në shërbim. Në kolonën 8, vendosni shumën e kolonës 6 vetëm nëse aseti është vënë në shërbim në vitin tatimore 2006 (periudhen tatimore 2006) per te cilen deklaroni. Nëse aseti nuk është vënë në shërbim në vitin tatimor 2006, vendoseni 0. Totali i kolonës 8 duhet të raportohet në kolonën 2 të tabelës J(b).

Në qoftë se shumat për transport dhe sigurim janë lejuar të kapitalizohen në kolonat 3 dhe 4 dhe janë përfshirë në shpenzimet në pasqyrat financiare, duhet të bëhet rregullimi në tabelën M.

**Çmimi i ndërtimit të aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 2 (zona 7).** Nëse asetit është ndërtuar në vend se të blehej, duhet të përgatitni nën-tabelën **zona 7** për të përcaktuar çmimin e ndërtimit. Në kolonën 1, shkruani emrin e asetit. Në kolonën 2, shkruani koston e materialeve të shfrytëzuara në ndërtim. Në kolonën 3, shkruani shumën e tatimeve të paguara në materialin e shfrytëzuar për ndërtim. Në kolonën 4, shkruani shumën e detyrimeve (doganore) të paguara në material. Në kolonën 5, shkruani shumën e kamatës së paguar në paratë e huazuara për të blerë materialet. Në kolonën 6, totali i koston të ndërtimit është totali i kolonave 2,3,4 dhe 5. Në kolonën 7, shkruani shumën e kolonës 6 vetëm nëse është e barabartë apo më e lartë se 1,000 € Nëse jo, shkruani 0. Në kolonën 8, shkruani datën kur është vënë asetit në shërbim. Kolona 9, vendosni totalin e kolonës 7 vetëm nëse asetit është vënë në përdorim në vitin Tatimor 2006 për të cilin deklaroni. Nëse asetit nuk është vënë në shërbim në vitin tatimor 2006, vendosni 0 në kolonën 9. Totali i kolonës 9 duhet të raportohet në kolonën 3 të tabelës J(b).

Në qoftë se shumat për tatimet e paguara, detyrimet doganore të paguara dhe kamatën e paguar janë lejuar të kapitalizohen në kolonat 3,4 dhe 5 dhe janë përfshirë në shpenzimet në pasqyrat financiare, duhet të bëhet rregullimi në tabelën M.

**Shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 2 (zona 8)** duhet të kapitalizohen nëse ato paraqesin më tepër se 5% të balancës totale në llogarinë në fillim të vitit 2006. Për të përcaktuar se a duhet të kapitalizohen, duhet të përgatitni nën-tabelën tuaj për të gjitha shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit për të gjitha asetet e kësaj kategorie. Kjo nën-tabelë duhet të identifikojë asetin, numrin kontraktues të faturës/mirëmbajtjes, kryesin e shërbimit, datën e shërbimit, dhe shumën e paguar apo të pagueshme. Totali riparimit ,mirembajtjes dhe përmirësimit për vitin 2006 për të gjitha asetet e kësaj kategorie duhet të regjistrohet në kolonën 1 të zonës 8. Në kolonën 2 të zonës 8, shkruani vlerën e pazhvlerësuar në fillim të vitit 2006 (nga kolona 1 e tabelës J(b)). Në kolonën 3, llogaritni 5% të kolonës 2. Nëse shuma në kolonën 1 tejkalon shumën në kolonën 3, vendosni shumën tepricë në kolonën 4 të tabelës J(b). Nëse jo, vendosni 0 në kolonën 4 të tabelës j(b).

Në qoftëse shumat e lejuara të kapitalizohen janë përfshirë në shpenzime në pasqyrat financiare, duhet të bëhen rregullime në tabelën M.

### **Shuma e shitjes e aseteve të amortizueshme të kategorisë 2 (zona 9)**

Kjo nën-tabelë është përmbledhje e aseteve të amortizueshme të kategorisë 2 që janë shitur gjatë vitit. Në kolonën 1, vendosni emrin e asetit. Në kolonën 2, vendosni datën e shitjes. Në kolonën 3, vendosni shumën e shitjes. Totali i kolonës 3 duhet të vendoset në kolonën 5 të tabelës J(b).

**Kategoria 3 – tabela J(c):** Të gjitha asetet që lidhen me këtë kategori duhet të përfshihen.

Në kolonën 1 të tabelës J(c) të kësaj periudhe tatimore(2006) , vendosni shumën nga kolona 8 e zonës 10 të periudhës tatimore paraprake(viti i kaluar 2005),por pasi të keni

zbritur vleren e aseteve te cilat kalojne ne kategorine e dyte. Në kolonën 2, vendosni shumën e kolonës 8 të zonës 11. Në kolonën 3, vendosni shumën e kolonës 9 të zonës 12. Në kolonën 4, vendosni shumën e kolonës 1 të zonës 13 vetëm nëse është më e lartë se shuma e kolonës 3 të zonës 13. Nëse jo, vendosni 0. Në kolonën 5, vendosni totalin e kolonës 3 të zonës 14.

Në kolonën 6, vendosni totalin e kolonave 1 deri 4, përfshirë, minus shuma e kolonës 5. Në kolonë 7, llogaritni zhvleresimin duke shumëzuar shumën në kolonën 6 me 15%.

Në kolonën 8, llogaritni vlerën e pazhvleresuar në fund të vitit duke zbritur shumën në kolonën 7 nga shuma në kolonën 6.

**Shuma e regjistruar në kolonën 7 të tabelës J(c) duhet të raportohet në kutinë 3 të kolonës 3 të tabelës J (Përmbledhja e kategorisë 1, 2 dhe 3 të aseteve të zhvleresueshme).**

**Vlera e pazhvleresuar në fillim të vitit tatimor e aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 3 (zona 10 – vlera e pazhvleresuar në fillim të vitit).** Kjo zbatohet tek asetet e blera perpara vitit tatimor 2006 (periudhes tatimore 2006), vetëm për bizneset që kanë hyrë në tatimin në te ardhura te korporatave gjatë periudhës tatimore 2006 per te cilen deklaroni. Për të përcaktuar vlerën e pazhvleresuar të këtyre aseteve në fillim të vitit (2006), duhet të plotësoni nën-tabelën **zona 10**. Në kolonën 1 të zonës 10, shkruani emrin e asetit. Në kolonën 2, shkruani vitin e blerjes. Në kolonën 3, vendosni numrin e viteve që nga blerja (viti tatimor per te cilin deklaroni minus viti i regjistruar në kolonën 2). Në kolonën 4, vendosni vlerën e asetit në kohën e blerjes. Në kolonën 5, vendosni zhvleresimin e akumuluar duke shumëzuar vlerën në kohën e blerjes (kol. 4) me përqindjen e zhvleresimit (15%) dhe me numrin e viteve që nga blerja (kol. 3). Për të siguruar vlerën e pazhvleresuar në fillim të vitit (kolona 6) zbritni zhvleresimin e akumuluar (kol. 5) nga vlera e asetit në kohën e blerjes (kol. 4).

Per qellime te zhvleresimit vlera e aseteve duhet te jete e dokumentuar me dokumentet percjellese.

Per qellime te zhvleresimit nuk do te pranohet vlera momentale e asetit bazuar ne vleren e tregut te asetit apo ndonje metode tjeter te vleresimit, por vlera e percaktuar bazuar ne shpenzimet reale te ndodhura dhe te dokumentuara.

Vleresimi i aseteve per qellime te tatimit ne prone nuk pranohet per qellime te tatimit ne korporata.

Secili aset i ketegorisë 3 që nuk është blerë gjatë vitit tatimor per te cilin deklaroni duhet të regjistrohet në nën-tabelën zona 10. Vendosni vlerën totale të kolonës 6 të zonës 10 në kolonë 1 të tabelës J(c).

**Kostoja e blerjes së aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 3 (zona 11).** Kjo zbatohet tek asetet e blera gjatë periudhes tatimore 2006. Për të përcaktuar çmimin e blerjes, duhet të përgatitni nën-tabelën **zona 11**. Në kolonën 1, shkruani emrin e asetit. Në kolonën 2, shkruani çmimin e blerjes. Në kolonën 3, shkruani shpenzimet e navllos (transportit). Në kolonën 4, shkruani koston e sigurimit nëse këni. Në kolonën 5, kostoja e blerjes është totali i kolonave 2, 3 dhe 4. Në kolonën 6, shkruani shumën e kolonës 5 vetëm nëse është e barabartë apo më e lartë se 1,000 € Nëse jo, shkruani 0. Në kolonën 7, shkruani datën kur është vënë aseti në shërbim. Në kolonën 8, vendosni shumën e kolonës 6 vetëm nëse aseti është vënë në shërbim në vitin tatimor per te cilin deklaroni. Nëse aseti nuk është vënë në shërbim në vitin tatimor 2006, vendosni 0. Totali i kolonës 8 duhet të raportohet në kolonën 2 të tabelës J(c).

Në qoftë se shumat për transport dhe sigurim janë lejuar të kapitalizohen në kolonat 3 dhe 4 dhe janë përfshirë në shpenzimet në pasqyrat financiare, duhet të bëhet rregullimi në tabelën M.

**Çmimi i ndërtimit të aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 3 (zona 12).** Nëse aseti është ndërtuar në vend se të blehej, duhet të përgatitni nën-tabelën **zona 12** për të përcaktuar çmimin e ndërtimit. Në kolonën 1, shkruani emrin e asetit. Në kolonën 2, shkruani koston e materialeve. Në kolonën 3, shkruani shumën e tatimeve të paguara në materialet e shfrytëzuara për ndërtim. Në kolonën 4, shkruani shumën e detyrimeve (doganore) të paguara në material. Në kolonën 5, shkruani shumën e kamatës së paguar në paratë e huazuara për të blerë materialet. Në kolonën 6, totali i koston të ndërtimit është totali i kolonave 2, 3, 4 dhe 5. Në kolonën 7, shkruani shumën e kolonës 6 vetëm nëse është e barabartë apo më e lartë se 1,000 € Nëse jo, shkruani 0. Në kolonën 8, shkruani datën kur është vënë aseti në shërbim. Në kolonën 9, vendosni totalin e kolonës 7 vetëm nëse aseti është vënë në përdorim në vitin tatimor për të cilin deklaroni . Nëse aseti nuk është vënë në shërbim në vitin tatimor, vendosni 0 në kolonën 9. Totali i kolonës 9 duhet të raportohet në kolonën 3 të tabelës J(c).

Në qoftë se shumat për tatimet e paguara, detyrimet doganore të paguara dhe kamatën e paguar janë lejuar të kapitalizohen në kolonat 3, 4 dhe 5 dhe janë përfshirë në shpenzimet në pasqyrat financiare, duhet të bëhet rregullimi në tabelën M.

**Shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të aseteve të zhvleresueshme të kategorisë 3 (zona 13)** duhet të kapitalizohen nëse ato paraqesin më tepër se 5% të balancës totale në llogarinë në fillim të vitit 2006 . Për të përcaktuar se a duhet të kapitalizohen, duhet të përgatitni nën-tabelën tuaj për të gjitha shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit për të gjitha asetet e kësaj kategorie. Kjo nën-tabelë duhet të identifikojë asetin, numrin kontraktues të faturës/mirëmbajtjes, kryesin e shërbimit, datën e shërbimit, dhe shumën e paguar apo të pagueshme. Totali për vit për të gjitha asetet e kësaj kategorie duhet të regjistrohet në kolonën 1 të zonës 13. Në kolonën 2 të zonës 13, shkruani vlerën e pazhvlerësuar në fillim të vitit (nga kolona 1 e tabelës J(c)). Në kolonën 3, llogaritni 5% të kolonës 2. Nëse shuma në kolonën 1 tejkalon shumën në kolonën 3, vendosni shumën që e tejkalon (teprice) në kolonën 4 të tabelës J(c). Nëse jo, vendosni 0 në kolonën 4 të tabelës j(c).

Në qoftëse shumat e lejuara të kapitalizohen janë përfshirë në shpenzime në pasqyrat financiare, duhet të bëhen rregullime në tabelën M.

### **Shuma e shitjes së aseteve të amortizuara të kategorisë 3 (zona 14)**

Kjo nën-tabelë është një përmbledhje e aseteve të amortizuara të kategorisë 3 që janë shitur gjatë vitit. Në kolonën 1, vendosni emrin e asetit. Në kolonën 2, vendosni datën e shitjes. Në kolonën 3, vendosni shumën e shitjes. Totali i kolonës 3 duhet të vendoset në kolonën 5 të tabelës J (c).

### **Kutia 23- Amortizimi (Kompletoni tabelën K)**

Për ta plotësuar tabelën K, duhet së pari t'i plotësoni nën-tabelat e **zonave 15 dhe 16**. Rregullimi i pasqyrave financiare (kolona 3) nëse ka, duhet të vendoset në kutinë 23 të deklaratës. Nëse shuma është negative, vëjeni në kllapa.

**Zona 15** është për amortizimin e shpenzimeve në **astetet e patrupëzuara** siç janë patentet, të drejtat autoriale, lejet për vizatime dhe modele, kontratat, franshizat. Këto asete kanë jetëgjatësi të dobishme të kufizuar dhe shpenzimet në këto asete duhet të



amortizohen gjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme duke e përdorur metodën lineare (metodë e vijës së rendit të parë). Jetëgjatësia e këtyre asetëve korrespondon me kohëzgjatjen e marrëveshjes legale.

Kolonat 1 deri në 4 të zonës së 15 janë vetë-sqaruese. Shpenzimet totale para periudhes tatimore per te cilen deklaroni (kolona 5) është gjithashtu vetë-sqaruese, sidoqoftë kjo shumë duhet të jetë plotësisht e argumentuar. Shuma e zhvlerësuar para periudhes tatimore (kolona 6) duhet të jetë shuma aktuale nëse dihet. Nëse nuk dihet shuma duhet të llogaritet si vijon: shpenzimet totale para periudhes tatimore (kolona 5) pjestuar me numrin e viteve të marrëveshjes legale (kolona 4), shumëzuar me numrin e viteve të kaluara që nga data e marrëveshjes legale (kol. 3). Në kolonën 7, shpenzimet për periudhen tatimore per te cilen deklaroni duhet të përmbledhen në nën-tabelën e ndarë dhe duhet të jenë plotësisht të argumentuara. Kolonat 8 dhe 11 janë vetë-sqaruese.

Nëse viti 2006 nuk është viti i fundit i marrëveshjes, amortizimi për 2006 në kolonën 10 do të jetë totali për amortizimin (kol. 9) pjestuar me numrin e viteve të marrëveshjes legale (kol. 4). Balanci mbyllës në vitin tatimor do të jetë ndryshimi në mes të totalit për amortizim (kol. 9) dhe shumës së amortizuar në vitin tatimor (kol. 10). Nëse periudha tatimore per te cilen deklaroni është viti i fundit i marrëveshjes, shuma në kolonën 9 do të jetë amortizimi për atë periudhë dhe balanci mbyllës në kolonën 11 do të jetë 0.

**Shuma e regjistruar në kolonat 10 dhe 15 duhet të vendosen në kolonën 1 të tabelës K.** Shuma e regjistruar në kolonën 11 të zonës 15 do të jetë bilanci i hapur për vitin e ardhshëm.

**Zona 16** është për amortizimin e shpenzimeve të eksplorimit dhe zhvillimit në lidhje me **depozitet natyrale të mineraleve dhe resurset tjera natyrore.**

Për ta përcaktuar bilancin e hapjes (kolona 2), ju duhet :

- (a) Të përgaditni listën e të gjitha shpenzimeve të lindura të eksplorimit dhe zhvillimit që nga fillimi i përgaditjes për eksplorim. Këto shpenzime duhet të jenë të argumentuara.
- (b) Të shumëzoni shumën në (a) me totalin e numrit të njësisve të nxjerrura që nga fillimi i eksplorimit.
- (c) Të pjestoni shumën në (b) me numrin e njësisve të nxjerrura nga depoziti.
- (d) Të zbritni shumën në (c) prej shumës në (a). Rezultati është bilanci i hapur.

Shpenzimet e eksplorimit dhe zhvillimit për vitin tatimor (kolona 3) dhe intereset e aplikueshme (kolona 4) duhet të përmbledhen në një nën-tabelë të ndarë dhe duhet të jenë plotësisht të argumentuara. Kolonat 5 dhe 8 janë vetë-sqaruese. **Shuma e regjistruar në kolonën 7 të zonës 16 duhet të vendoset në kolonën 2 të tabelës K.** Balanci përmblyllës në kolonën 8 do të bëhet bilanci i hapjes në vitin e ardhshëm.

Numri total i vlerësuar i njësisve në deposit duhet të merret nga raporti i ekspertëve të pavarur dhe duhet të jetë në dispozicion për Administratën Tatimore me kërkesën e tyre. Administrata Tatimore e mban të drejtën t'i përdor shërbimet e ekspertëve të pavarur për t'i rishikuar raportet e tilla.

#### **Kutia 24- Lejesat speciale për asetet e reja (Kompletoni tabelën L).**

Tabela L është vetë-sqaruese. Kjo lejesë aplikohet vetëm tek asetet e reja të zhvlerësueshme të kategorisë 3. Kostoja e blerjes dhe kostoja e konstrukcionit veç janë në dispozicion në kolonat 2 dhe 3 të tabelës J (c). Shuma në kolonën 4 të tabelës L duhet të raportohet në kutinë 24 të deklaratës.

**Kutia 25- Humbja kapitale.** Nëse shuma në kolonën 6 të tabelës C është humbje, duhet të raportohet në kutinë 25.

**Kutia 26- Shpenzimet/Humbjet tjera (*Kompletoni tabelën M*).**

**Përmirësimi i qiradhënjes.** Nëse jepni me qira objektet dhe e keni bërë punë renovuese ose riparime substanciale në vitin tatimor, ju keni të drejtë që të merni **amortizim për përmirësimin e qiradhënjes**. (Referohuni në kutinë 13, tabela C, Zona (a) të këtij doracakut për definicionin e “punë renovuese” dhe “riparim thelbësor”).

Për ta llogaritur amortizimin, përgaditni nën-tabelen e juaj personale e cila duhet të bëhet që të jetë në dispozicion të inspektorëve tatimor. Për t’u përgaditur nën-tabelën tuaj, ju duhet (a) të përgaditni listën e të gjitha shpenzimeve të lindura; (b) duhet t’u pjestoni totalin në (a) me numrin e viteve të parpara në marrëveshjen e qirasë. Shuma në (b) është shpenzimi i amortizuar i lejueshëm për vit. **Vendosni këtë shumë në kolonën 2 të tabelës M;** (c) duhet të llogaritni bilancin e mbylljes duke e hequr amortizimin për vitin tatimor nga shpenzimet totale të lindura në vitin tatimor. Ky bilanc i mbylljes do të jetë bilanci i hapjes për vitin e ardhshëm. Të gjitha shpenzimet duhen të argumentohen plotësisht me fatura. Verifikimi i tërthortë mund të bëhet me kontraktorët dhe/ose furnizuesit.

Vendosni shumën e raportuar në raportet financiare për përmirësimin e qiradhënjes në kolonën 3 të tabelës M. Llogaritni rregullimin në kolonën 4.

**Kontributet bëmirëse.** Vetëm 5% të **fitimit të tatueshëm** është i lejuar për kontributet bëmirëse. Shuma e lejuar do të llogaritet në kutinë 29. Prandaj shuma totale e përfshirë si shpenzim në raportet financiare duhet të zbritet. Në kolonën 2 të tabelës M, shuma e lejueshme është 0. Në kolonën 3 të tabelës M, vendosni shumën totale të kolonës 3 në tabelën N. Rregullimi në kolonën 4 të tabelës M është reduktimi i shpenzimeve të lejueshme.

**Shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit.** Për të shmangur dyfishimin nëse shuma totale, apo pjesa e shumës totale për shpenzime të riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të regjistruara në kolonën 4 të tabelave J(a), J(b) dhe J(c) është përfshirë nën një kategori tjetër nga amortizimi në pasqyrat financiare, kjo shumë duhet të rregullohet në kutinë 3 të tabelës M. Ju duhet të përgatitni përmbledhjen tuaj dhe ta mbani në dispozicion për inspektorët tatimor.

**Transporti dhe sigurimi në blerjet e aseteve të zhvleresueshme dhe tatimet, detyrimet doganore dhe kamata të paguara në materialet e shfrytëzuara në ndërtimin e aseteve të zhvleresueshme** që janë kapitalizuar në zonat 2 dhe 3 të tabelës J(a), zonat 6 dhe 7 të tabelës J(b) dhe zonat 11 dhe 12 të tabelës J(c) duhet të rregullohen në kutinë 4 të tabelës M nëse ato janë regjistruar si shpenzime në pasqyrat financiare.

**Blerja/ndërtimi i aseteve të zhvleresueshme më të vogla se 1,000 €** Nëse shumat totale apo pjesët e shumave të lejuara për zhvlerësim në kolonën 6 të zonës 6 dhe 7 të tabelës J(b) dhe kolonës 6 të zonave 11 dhe 12 të tabelës J(c) janë kapitalizuar, lejohet rregullimi në kutinë 5 të tabelës M. Rregullimi duhet plotësisht të argumentohet.

**Tjerat.** Sikurse për kutinë 15, ju duhet të përfshini çdo lloj të shpenzimeve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të cilat mund të rrjedhin nga shpërndarja e pronësisë, likuiditeti, riorganizimi, etj.

Rregullimi total në pasqyrat financiare duhet të vendoset në kutinë 26 të deklaratës.

**Kutia 27-** Rregullimi në shpenzime mund të rezultojë në rritje apo ulje. Për shumicën e tatimpaguesve, rregullimi në shpenzime duhet të rezultojë në uljen e shpenzimeve.

**Kutia 28**- Nëse shuma në kutinë 17 është fitim, një rritje në shpenzime do të zvogëlojë fitimin dhe një ulje në shpenzime do të rrisë fitimin. Nëse shuma në kutinë 17 është humbje, një rritje në shpenzime do të rrisë humbjen dhe një ulje në shpenzime do të zvogëlojë humbjen.

**Kutia 29**- **Kontributet bëmirëse të lejueshme (Kompletoni tabelën N).** Për qëllime të tatimit në fitim, vetëm 5% e **fitimit** nga kutia 28 e deklaratës është e lejueshme si shpenzim.

Kolonat 1 dhe 2 janë vet-sqaruese. Në kolonën 3, regjistroni shumën e secilit kontribut bëmirës dhe llogaritni totalin kutiza [a]). Vendosni totalin në kutizën 4, kutia 2 e tabelës M.

Në kutinë tjetër pasuese, llogaritni kontributin e lejueshëm duke e shumëzuar kutinë 28 të deklaratës me 5%. Vendosni rezultatin në kutizën [b] të tabelës N.

Nëse shuma në kutizën (a) është më e lartë se shuma në kutizën (b), vendosni shumën në kutizën (b) të kutisë 29 të deklaratës. Nëse shuma në kutizën (a) është më e ultë se shuma në kutizën (b), vendosni shumën në kutizën (a) të kutisë 29 të deklaratës.

**Kutia 30**- Humbjet e bartura nga viti paraprak

**Kutia 31**- Është vet-sqaruese.

**Kutia 32**- Nëse rezultati në kutinë 28 është fitim, kutia 31 do të zvogëlojë fitimin. Nëse rezultati në kutinë 28 është humbje, kutia 31 do të rrisë humbjen.

Nëse shuma në kutinë 32 është humbje, kjo humbje do të jetë në dispozicion për t'u bartur në vitet vijuese.

**Koeficienti i rregullimit për OJQ-të me Status të Përfitimit Publik** - Nëse një pjesë e të ardhurave të OJQ-ve me status të përfitimit publik nuk përdoren **ekskluzivisht** për qëllimet e tyre të përfitimit publik, ajo pjesë e të ardhurave të tyre është e tatueshme. Këto OJQ duhet t'i përgadisnin deklaratat e tyre tatimore ashtu si është treguar por koeficienti i tatueshëm do të jetë thyesë, numëruesi i të cilit është pjesa e të ardhurave që nuk përdoret për qëllimet e tyre për përfitime publike, ndërsa emruet (i thyesës) janë të ardhurat totale. Koeficienti i rregullimit duhet të rregullohet më tutje siç është përshkruar në paragrafin “koeficienti i përgjithshëm i rregullimit”.

Të supozojmë se të ardhurat e OJQ “ABC” janë € 500.000 për vitin 2006. Le të supozojmë se një pjesë e të ardhurave (€50.000) është përdorur për qëllime tjera ndryshe nga përfitimi publik. Prandaj, pjesa e tatueshme është 1/10 kete vlere duhet ta vendosni në kutin 32 te deklarates tatimore.

OJQ-të me status të përfitimit publik të ardhurat totale të të cilit janë përdorur për qëllimet e përfitimit publik do ta kenë koeficientin 0 të fitimit të tatueshëm. Këto OJQ duhen t'i dorzojnë deklaratat e tyre për tatim në fitim pa llogarijen e përmirsimeve. Sidoqoftë këto OJQ duhen t'i nënshtrohen kontrollës.???

## Rimbursimi ose shuma borxh

**Kutia 33-** Tatimi në të ardhurat e korporatave – Shuma e tatimit në fitim të korporates është llogaritur duke shumëzuar kutin 32 me 20% nëse shuma në kutinë 32 është fitim. Nëse shuma në kutinë 32 është humbje, vendosni 0 në kutinë 33.

**Kutia 34-** Vendos shumën e Primeve bruto për periudhën tatimore. Kompanitë e sigurimeve që **aktiviteti i tyre kryesor** është sigurimi i jetës i pronës ose reziqëve tjera me rastin e plotësimit të deklaratës tatimore në kutin dhjetë [10] (fitimi neto financiar) të deklaratës tatimore, duhet të vendosni Zero [0]

**Kutia 35-** Tatimi në të ardhurat e korporatave për kompanitë e sigurimeve [34] x 7%

**Kutia 36** – Mblidh shumën në kutin [33] me kutin [35] sipas situatës tuaj

**Kutia 37-** Kredia tatimore e shtetit të jashtëm (*Kompletoni tabelën O*).

Për t'ua kompletuar tabelën O, më së pari duheni t'i plotsoni zonat 17 dhe 18. Vendosni totalin e kolonës 8, zona e 17, në kolonën 1 të tabelës O. Vendosni totalin e kolonës 9, zona 18, në kolonën 2 të tabelës O. Vendosni totalin (kolona 3) e tabelës O në kutin 34 të deklaratës.

**Tatimi në fitim i paguar në themelatat (njësit) e përhershme jashtë Kosovës (zona 17).** Nëse keni një ose disa themelatë(a) (njësi) të përhershme jashtë Kosovës dhe e keni paguar tatimin në fitim në cilindo shtet ku ju e keni themelaten e përhershme, ju keni të drejtën e kredisë për tatimin në korporata që keni paguar me kusht që shuma nuk është më e lartë se shuma që do të kishit paguar në Kosovë. Kërkohej certifikatë zyrtare e Autoriteteve Tatimore të shtetit të huaj.

Kutiat 1 deri në 3 të zonës 17 janë vet-sqaruese. Koeficienti i konvertimit (kolona 4) është koeficienti në ditën kur është paguar tatimi në fitim. Kolonat 5 dhe 6 janë vet-sqaruese. Në kolonën 7, duhet të përcaktoni shumën e tatimit që do të paguhej në Kosovë. Prandaj, duhet t'ua shumëzoni fitimin e tatueshëm të konvertuar në kolonën 5 me 20%. Duke e marrë parasysh kredinë e lejueshme (kolona 8), nëse shuma në kolonën 6 është më e ulët se shuma në kolonën 7, kredia e lejueshme është shuma e kolonës 6. Nëse shuma në kolonën 6 është më e lartë se shuma në kolonën 7, kredia e lejueshme është shuma e kolonës 7.

Vendosni totalin e kolonës 8, zona 17, në kolonën 1 të tabelës O.

**Tatimi i mbajtur në burim nga Shteti i Huaj për të ardhura tjera (zona 18).** Tatimi mund të mbahet në burim nga shteti i huaj në të ardhurat nga dividendat, kamata, shitja e pronës, aktivitetet e biznesit ndryshe nga themelatat e përhershme jashtë Kosovës, etj. Nëse është një rast i tillë, **ju keni të drejtë për kredi tatimore me kusht që t'i keni përfshirë ato të ardhura në deklaratën tuaj.** Kërkohej certifikatë zyrtare e Autoriteteve Tatimore të shtetit të huaj.

Data (kolona 1) është data kur nga shteti i huaj është mbajtur tatimi në burim. Natyra (kolona 2) është lloji i të ardhurave, për shembull "dividendat". Kolonat 3 dhe 4 janë vet-sqaruese. Koeficienti i këmbimit (kolona 5) është koeficienti kur tatimi është mbajtur në

burim. Kolona 6 dhe 7 janë vet-sqaruese, Në kolonën 8, e llogaritni tatimin që do të paguhej në Kosovë. Kështu që ju e shumëzoni shumën e tatueshme të konvertuar në kolonën 6 me 20%. Duke e marrë parasysh kredinë e lejueshme (kolona 8), nëse shuma në kolonën 7 është më e ulët se shuma në 8, kredia e lejueshme është shuma e kolonës 7. Nëse shuma në kolonën 7 është më e lartë se shuma në kolonën 8, kredia e lejueshme është shuma e kolonës 8.

Totali i kolonës 9, zona 18, duhet të raportohet në kolonën 2 të tabelës O.

**Kutia 38**- Tatmi i mbajtur në burim nga te tjeret per te ardhurat nga: **dividenda, interesat, Qirate Rojalties (të drejtat e licencave/autorit) (Kompletoni tabelën P).**

Kjo tabelë është vet-sqaruese. Ju duhet ti bashkangjitni qertifikatat e tatimit te mbajtur ne burim nga te tjeret. Poashtu të siguroni se të gjitha dokumentet përkrahëse mbahen në dispozicion për kontrollim nga Administrata Tatimore.

Totali i kolonës 10 duhet të raportohet në kutinë 38 të deklaratës.

**Kutia 39**- Totali i kredive per periudhen ( 37+38 )

**Kutia 40**- Kutia [36] minus [39]

**Kutia 41**- Këstet e paguara (Kompletoni tabelën Q). Kjo tabelë është vet-sqaruese. Totali duhet të vendoset në kutinë 41 të deklaratës.

**Kutia 42**- Kutia [40] minus [ 41]

**Kutia 43**- Obligimi Tatimor

**Kutia 44**- Informatat duhet të vendosen në kolonën e rimbursimit pa marrë parasysh se a keni të drejtë në rimbursim apo jo.

Nëse rimbursimin nuk dëshironi ta bartni në xhirollogarinë tuaj por dëshironi të mbuloni ndonjë obligim tjetër tatimor atëherë duhet ta plotësoni një formë të veçantë në Administratën Tatimore të Kosovës

Mirpo nëse keni ndonjë borxh të pashlyer ndaj Administratës Tatimore, atëherë ai borgj do të mbulohet me pjesën e rimbursimit të aprovuar nga Administrata Tatimore.

**Kutia 45** - Duhet të shenohet emërtimi i bankës

**Kutia 46** - Shenohet emri i personit(juridik apo fizik) emrin e të cilit e mban llogaria

**Kutia 47** - Shenohet numri i llogarisë në të cilën tatimpaguesi dëshiron t'i barten mjetet.

**Kutia 48** - Barteni shumen nga kutia [43]

**Kutia 49** - Shuma e tatimit qe do te paguhet me kete deklarate